

Komp. I, Pika 1

2. Dardhë-Qebik
Per Jepun ALPES
20.03.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MJEDISIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MJEDISIT
DREJTORIA E BIODIVERSITETIT

BASHKIA FUSHË - ARRËZ
Nr. 1636 prot. Dt. 20.5.26
Rel: Përdore

Nr. 1678/2 Prot.

Datë 18.5.2026

Lënda:

Miratim i planit të mbarështimit për pyjet dhe kullotat, Ekonomia Pyjore
"Dardhë-Qebik"

Z. Hil CURRI

Kryetar

BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Qendër, "Fushë-Arrëz"

I nderuar Z. Curri,

Në përgjigje të shkresave Bashkia Fushë-Arrëz me shkresën nr.787/1 Prot., datë 10.03.2026 (portokolluar në Ministrinë e Mjedisit me datë 10.4.2026) "Kthim përgjigje shkresës nr.148/1, datë 03.03.2026", drejtuar Ministrisë së Mjedisit, bazuar në kriteret teknike e ligjore, ju bëjmë me dije se:

Struktura e planit të mbarështimit për ekonominë pyjore "Dardhë-Qebik", me sipërfaqe të përgjithshme prej 3974.4 ha (3606 ha, pyll, 21.3 ha, kullotë, 306.2 ha, sipërfaqe me bimësi pyjore, 3.9 ha, djerrë dhe inproduktive) është e bazuar në Udhëzuesin "Për hartimin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave", me objektivat kryesore e specifike që orientojnë ekonominë pyjore drejt menaxhimit të duhur, duke angazhuar dhe përfshirë komunitetin për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor, në pronësi të bashkisë.

Plani i mbarështimit dhe pëmbajtja e tij, vijnë në përputhje me udhëzimet teknike e ligjore të hartimit e miratimit të tij ashtu edhe me objektivin për menaxhim të qëndrueshëm. Më konkretisht, struktura e planit të hartuar është e duhura, analiza e grumbujve pyjore me treguesit dendrometrikë është e plotë, fletët (skedat) e përshkrimit të ngastrave dhe nënngastrave përputhen me shtjellimin e tyre në plan, ndërhyrjet janë konkrete, nominalisht për ngastër apo nëngastër dhe sipas urgjencës.

Gjithashtu shtrirja gjeografike dhe vendosja e sipërfaqeve prove të përhershme në të, detajohen dhe pasqyrohen mirë. Të dhënat për moshën janë të plota, sipërfaqet pasqyrohen njëllëj, jepen medotat e llogaritjes së mundësisë së shfrytëzimit, hartat e ekonomisë pyjore me rrjetin e pikave të sipërfaqeve të përhershme, tipeve të pyjeve e kullotave, funksioneve, ndërhyrjeve, rrjetit rrugor, infrastrukturës dhe zonave të degraduara, janë sipas udhëzuesit.

Sa më sipër dhe bazuar në germën (b), pika 2, neni 11, të ligjit 57/2020, dat 30.4.2020, "Për pyjet", konfirmojmë për zbatim planin 10-vjeçar të mbarështimit, për ekonominë pyjore "Dardhë-Qebik", pjesë përbërëse e fondit pyjor në pronësi të bashkisë Fushë-Arrëz.

Njëkohësisht duke vlerësuar hapat e ndërmarrë nga ju, lidhur me miradministrimin e fondit pyjor e kullosor, sidomos hartimin e planeve të mbarështimit apo realizimit të investimeve me fondet e vetë bashkisë, kërkojmë që struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, të bëjë përditësimet përkatëse në regjistrin e fondit pyjor dhe hedhjen e të dhënave në sistemin "ALFIS".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

MINISTËR

SOFJAN JAUPAJ



PLANI I MBARESHTIMIT

EKONOMIA PYJORE DARDHE QEBIK

BASHKIA FUSHE ARREZ



PLANI I MBARËSHTIMIT PËR EKONOMINË PYJORE “DARDHE QEBIK” Periudha e vlefshmërisë: 2025-2034

Grupi i punës

Inxhinier pyjesh Hazis Porja

Inxhinier topograf Mustafa Hoxha

Teknik pyjesh Besim Pasha

HARTOI

“DEJA” shpk

ADMINISTRATORI

INXH. HAZIS PORJA

Viti 2025

PËRMBAJTJA E PLANIT TË MBARËSHIMIT TË EKONOMISË PYJORE **“DARDHE QEBIK”**

1. HYRJE

- 1.1. Qëllimi dhe objektivat e planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave,
- 1.2. Ecuria e punës dhe përgjegjësitë
- 1.3. Metodologjia e punës
- 1.4. Informacioni i përdorur në hartimin e PMPK

2. PERSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I EKONOMISË PYJORE

- 2.1. Informacion i përgjithshëm rreth ekonomisë pyjore
- 2.2. Pronësia, administrimi, organizimi
- 2.3. Vendndodhja gjeografike dhe ndarja administrative
- 2.4. Konteksti i bashkisë dhe ekonomisë pyjore
- 2.5. Historiku i mbarështimit të pyjeve dhe kullotave në ekonominë pyjore
- 2.6. Situata demografike dhe social ekonomike
- 2.7. Marketingu i produkteve pyjore drusore dhe jo drusore
- 2.8. Gjuetia dhe peshkimi
- 2.9. Fasilitetet rekreacionale dhe didaktike
- 2.10. Prania e zonave të mbrojtura, specieve dhe stacioneve

3. GJENDJA AKTUALE E PYJEVE DHE KULLOTAVE

- 3.1. Mbarështimi dhe funksionet e pyjeve dhe kullotave
 - 3.1.1. Përdorimi i territorit (aktual dhe propozimet)
 - 3.1.2. Forma e qeverisjes (aktuale dhe propozimet)
 - 3.1.3. Ndarja e ekonomisë pyjore në parcela dhe nënparcela
 - 3.1.4. Ndarja e pyjeve

4. KUSHTET STACIONALE

- 4.1. Klima
- 4.2. Topografia dhe morfologjia
- 4.3. Gjeologjia
- 4.4. Tokat
- 4.5. Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë
- 4.6. Erozioni në shpate dhe rrjedhjet ujore
- 4.7. Rrëshqitjet

5. VEGJETACIONI DHE BIODIVERSITETI

- 5.1. Brezat bioklimatike

- 5.2. Pyjet dhe kullotat
- 5.3. Tipet e pyjeve
- 5.4. Tipet e kullotave
- 5.5. Tipet potenciale të vegjetacionit
- 5.6. Biodiversiteti
- 5.7. Prania e vlerave konservuese të larta (VKL)
- 5.8. Rreziqet për biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin
- 5.9. Mundësitë për aktivitetet didaktike dhe kërkim shkencor

6. ANALIZA E PYJEVE DHE KULLOTAVE

- 6.1. Analiza e të dhënave për Pyjet
 - 6.1.1. Analiza e tipeve të pyjeve
 - 6.1.2. Shpërndarja e sipërfaqes dhe volumit sipas formës së qeverisjes
 - 6.1.3. Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimit
- 6.2. Analiza e të dhënave të kullotave
 - 6.2.1. Gjendja e kullotave
 - 6.2.2. Madhësia e sipërfaqes së kullotave dhe vendodhja e tyre
 - 6.2.3. Altituda, pjerrësia, kundrejtimi, kushtet hidrologjike
 - 6.2.4. Mbrritshmëria
 - 6.2.5. Grumbullimi i të dhënave për zonat e djegura në kullota(10 vitet e fundit)

7. REZULTATET E INVENTARIZIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

- 7.1. Rezultatet e Inventarizimit të Pyjeve
 - 7.1.1. Analiza statistikore e Inventarizimit
 - 7.2.2. Volumi dhe rritja në volum e grumbujve pyjorë
 - 7.2.3. Struktura Vertikale
 - 7.2.4. Cilësia e materialit drusor
 - 7.2.5. Biomasa dhe faktorët e ekspansionit të biomasës
 - 7.2.6. Analiza e rolit të ekonomisë pyjore në sekuestrimin e karbonit
- 7.2. Gjendja shëndetsore dhe fitosanitare
 - 7.2.1. Drurët e tharë
 - 7.2.2. Dëmtimet e tjera
- 7.3. Prerjet e paligjshme
 - 7.3.1. Prerjet e paligjshme, gjendja aktuale dhe efektet në procesin e planifikimit
 - 7.3.2. Impakti i prerjeve ilegale në planifikimin dhe mbarështimin e pyjeve
- 7.4. Rezultatet e inventarizimit të kullotave
 - 7.4.1. Tipi dhe cilësia e kullotave
 - 7.4.2. Përdoruesit e kullotave dhe koha
 - 7.4.3. Llojet e bagëtive
 - 7.4.4. Përdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtës i kullotave
 - 7.4.5. Infrastruktura aktuale

7.4.6. Problemet mbi kullotjen dhe furnizimin e blegtorisë me baze ushqimore

7.4.7 Volumi dhe rritja në volum e grumbujve pyjorë

8. OBJEKTIVAT E MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

8.1. Objektivat e përgjithshme për planifikimin afat-gjatë

8.2. Objektivat kombëtare për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave pajtueshmëria e PMPK me planifikimin rajonal dhe atë në nivel Bashkie

8.3. Objektivat kryesore të PMPK

8.4. Objektivat specifike të ekonomisë pyjore/NJM

8.5. Objektivat specifike mbi përdorimin e tokës, funksionin dhe formën e qeverisjes

8.5.1. Objektivat specifike mbi tipet e pyjeve

8.5.2. Objektivat specifike silvikulturale

8.5.3. Objektivat specifike për kullotat

8.5.4. Objektivat specifike mbi biodiversitetin

8.5.5. Objektivat specifike mbi gjendjen shëndetsore

8.5.6. Objektivat specifike mbi faunen

8.5.7. Objektivat specifike për pyjet me funksion prodhues

8.5.8. Objektivat specifike për pyjet me funksion mbrojtës

8.5.8. Objektivat specifike për pyjet me funksion rekreacioni

8.5.9. Objektivat specifike për pyjet me funksion konservues

9. MASAT/AKTIVITETET E PLANIFIKUARA NË KUADËR TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

9.1. Prerja vjetore e lejuar/mundësia vjetore e shfrytëzimit

9.2. Prerja vjetore silvikulturore

9.3. Planifikimi vjetor i masave

9.3.1. Masat në pyje

9.3.2. Masat në kullota

9.3.3. Masat në infrastrukturë, në zonat e degraduara, rekreacionale dhe didaktike

9.4. Masat afat-gjata

9.4.1. Masat silvikulturale në trungishte

9.4.2. Masat silvikulturore në cungishte

9.4.3. Masat silvikulturore në shkurre

9.4.4. Pyllëzimi, ripyllëzimi

9.4.5. Masat në kullota

9.4.6. Gjendja dhe masat në infrastrukturën e ekonomisë pyjore

9.4.7. Masat specifike për aktivitetet rekreacionale dhe didaktike

10. VLERËSIMI EKONOMIK

10.1. Vlerësimi i efekteve të masave të planifikuara në pyje dhe kullota

10.2. Planifikimi i të ardhurave/perfitimeve

10.3. Planifikimi i kostove/shpenzimeve

10.4. Analiza kosto-përfitim

11. LIDHJA MIDIS PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE E KULLOTAVE DHE SISP

12. PROÇESI I VALIDIMIT TË PMPK NË SISP

13. MIRATIMI I PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

14. MONITORIMI I ZBATIMIT TË PMPK

15. RISHIKIMI PERIODIK I ZBATIMIT TË PLANIT TË MBARËSHTIMIT

16. RISHIKIMI AFAT-MESËM I PLANIT TË MBARËSHTIMIT

17. RISHIKIMI FINAL I PLANIT TË MBARËSHTIMIT

18. PËRGATITJA E HARTAVE

- Hyrje.
- Harta e ekonomisë pyjore
- Harta e funksioneve
- Harta e tipeve të pyjeve dhe kullotave
- Harta e rrjetit rrugor, infrastrukturës dhe zonave të degraduara
- Harta e ndërhyrjeve

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbarështimi i pyjeve është planifikimi afatgjatë për fondin pyjor, i cili në rastin konkret është bërë në bazë të kriterëve të caktuar për grumbullimin e informacionit për gjendjen faktike dhe përcaktimin e objektivave e masave të nevojshme, në funksion të statusit të dhënë, me synim përmbushjen e funksioneve ekologjike, ekonomike e sociale, duke zbatuar dhe harmonizuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm me nevojat e administruesve, te pronarëve privat dhe përdoruesve të tyre. Plani i Mbarështimit të Ekonomisë pyjore **Dardhe Qebik**, synon që të merren në konsideratë të gjithë faktorët që lidhen direkt ose indirekt ndërmjet tyre - popullata lokale, faktorët ekologjik dhe tokësore, administrimi i pyjeve dhe kullotave, ekoturizmi, interesi që ofron pylli, blegtorët etj., pa harruar shërbimet në ekosistem që pylli ofron, të tilla si; kufizimin e erozionit, mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ujrave, ruajtjen e natyrës dhe qëndrueshmërinë e resurseve, mbrojtja e tokave bujqësore dhe infrastrukturës etj. Nga ana tjetër pylli përmbush edhe funksione të tjera si; plotësimi i nevojave me material drusor, bazë ushqimore për blegtorinë, si dhe përdorimi i prodhimeve të dyta pyjore përdorimi dhe përftimi i të cilave duhet bërë nëpërmjet një zhvillimi të qëndrueshëm të pyjeve. Mbrojtja e ekosistemeve natyrore, përmirësimi i peisazhit rural dhe mbrojtja e biodiversitetit përbën një drejtim të rëndësishëm të projektit dhe zgjerimi i këtyre zonave do të jetë në qendër të objektivave të veçantë.

Gjithashtu vend të veçantë zë harmonizimi i interesave të komunitetit dhe të pjesëmarrësve të tjerë veprues në territorin e kësaj ekonomie, në përputhje me mundësi prodhuese aktuale dhe potenciale të pyllit.

Ekonomia pyjore Dardhe Qebik shtrihet në territorin e Bashkisë Fushe Arrez, dhe popullsia që shtrihet brenda territorit të ekonomisë pyjore përbëhet nga 612 banorë, me 153 familje dhe rreth 241 krahë aktive pune.

Pyjet me funksion me funksion prodhues zënë **3606** ha ose 100 % të sipërfaqes pyjore. Grumbujt pyjorë të kësaj ekonomie qeverisen si më poshtë:

- ❖ Pyjet trungishte zënë 1845.5 ha ose 51.2 % të sipërfaqes pyjore,
- ❖ Pyjet cungishte zënë 939.9 ha ose 26.1 % të sipërfaqes pyjore,
- ❖ Pyjet trungishte e parregullt zënë 557.8 ha ose 15.5 % të sipërfaqes pyjore,
- ❖ Pyjet cungishte e perbere zene 262.8 ha ose 7.3 % të sipërfaqes pyjore,

Në aspektin e organizimit natyror kjo ekonomi paraqet një ndërthurje të mirë të elementeve ekstensiv dhe intensive të burimeve dhe resurseve pyje, kullota, fond bujqësor, ujra, florë, faune dhe mbi të gjitha faktori njeri si përfitues, përdorues i këtyre burimeve.

Gjithsesi, kërkohet një edukim i vazhdueshëm dhe menaxhim afatgjatë e i qëndrueshëm për ti vënë në funksion të përmiresimit të cilësisë së jetesës për komunitetet dhe grupet e interesit në zone.

Problematika kryesore në zone ka të bëjë me migrimin dhe emigrimin e brezit të ri, burime të kufizuara financiare për familjet, si dhe menaxhimi jo i qëndrueshëm i burimeve natyrore.

Detyrat kryesore për 10 vjeçarin e ardhshëm në zbatim të këtij Plani Mbarështimi rrjedhin nga programi strategjik i Qeverisë Shqiptare për zhvillimin e sektorit pyjeve e kullotave në harmoni të plotë me programet e Bashkisë Fushe Arrez.

1.HYRJE

1.1. Qëllimi dhe objektivat e Planit të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave

Qëllimi kryesor i hartimit të planit të mbarështimit është rishikimi dhe hartimi i një plani që të plotësojë objektivat afat-shkurtra dhe afat-gjata në përputhje me tipet e grumbujve pyjorë.

Në objektivat e këtij plani mbarështimi një vend të rëndësishëm zë qëllimi primar “*sigurimi i një mbarështimi të qëndrueshëm dhe shumë funksional i pyjeve*”. Gjithashtu, ky plan mbarështimi duhet të garantojë përdorim racional të burimeve natyrore pyjore dhe kullosore, si dhe të kontribuojë në cilësinë e jetesës në zonën rurale.

Objektivat e projektit të ri janë prezantuar tek të gjithë aktorët, duke e organizuar punën për administrimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave të Ekonomisë Pyjore.

Objektivat e planit të mbarështimit u hartuan në mbështetje të ligjit për zhvillimin e sektorit pyjore, ligji kuadër 57/2020 “Për pyjet” dhe në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për pyjet në Bashki, popullatën dhe organet e pushtetit vendor. Objektivat kryesore janë:

- Sigurimi i normalitetit në grumbujt pyjorë, që të garantojnë një zhvillim të qëndrueshëm dhe një përdorim racional duke siguruar prodhim maksimal nga grumbujt pyjor.
- Vlerësimi i pyllit si ekosistem multifunksional për ruajtjen e biodiversitetit dhe shtimit të të ardhurave në dobi të popullatës lokale.
- Intesifikimi i rritjes natyrore të grumbujve duke kryer ndërhyrjet e domosdoshme silvikulturore dhe duke vjelë në mënyrë racionale materialin drusor nga grumbujt pyjorë.

- Shtimi i sipërfaqes së mbulesës pyjore dhe sigurimi i ripërtëritjes natyrore nëpërmjet kryerjes së punimeve për sigurimin e gjeneratës së re të pyjeve në ato pjesë të territorit ku ajo mungon ose është dëmtuar.
- Përmirësimi përbërjes llojore, duke stimuluar përzierjet fletorë + halorë.
- Rritje e cilësisë së kërcellit dhe e kurorës së drurëve me synim përmirësimin e cilësisë e prodhimit të grumbujve.
- Përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës rrugore dhe rritja e sipërfaqes së grumbujve pyjorë të mirëshërbyer prej saj, mirëmbajtja dhe shtrirja optimale e rrjetit rrugor.
- Përpjekja maksimale për kontrollin e erozionit dhe mbrojtjen e burimeve ujore.
- Pakësimi i ndikimit negativ në gjendjen shëndetsore të pyjeve dhe ndalimi i veprimtarive të paligjëshme në territorin pyjor dhe kullësor.
- Vlerësimi i mundësisë prodhuese të produkteve jodrusore pyjore dhe zbatimi i praktikave mirëmenaxhuese të vjeljes së tyre.
- Të krijojë mundësi për zhvillimin e turizmit natyror dhe rural në zonë dhe të evidentojë pjesët e territorit me vlera të larta peisazhiste, historike, kulturore apo me vlera të veçanta tradicionale lokale.

1.2.Ecuria e punës dhe përgjegjësitë

Fillimisht është kryer puna përgatitore për sigurimin e bazës materiale, si instrumentet e ndryshëm, dokumentacionin e nevojshëm, si planin e inventarizimit aktual, hartat topografike e ato të ndarjes parcelare, përgatitjen e formulareve për punimet e terrenit, tabletat etj.

Puna për grumbullimin e informacionit të nevojshëm në terren ka filluar në Maj 2025 dhe ka përfunduar në Gusht 2025. Periudha në vijim ka shërbyer për kryerjen e punimeve të zyrës e përpilimin e relacionit të planit të mbarështimit.

Realizimi i mbarështimit të ekonomisë pyjore “Dardhe Qebik” është mbështetur në zbatimin kritereve të përshkruara në Udhëzuesin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave (punimet e terrenit dhe ato të zyrës). Operacionet e punës janë kryer mbështetur në grafikun e realizimit të punimeve bashkangjitur kontratës si më poshtë:

- ✓ Përcaktimi i objektivave të planit të mbarështimit
- ✓ Rikonicioni i plotë i ekonomisë me grupin e mbarështimit, përfaqësues të organeve të pushtetit lokal e të Drejtorisë Pyjeve të Bashkisë Fushe Arrez.
- ✓ Grumbullimi i informacionit për ekonominë nga dokumentacioni ekzistues si: planet e mbarështimit të mëparshëm, regjistrat e kryerjes së punimeve pyjore, regjistri i zjarreve, sëmundjeve dhe dëmtuesve, regjistrat e shfrytëzimit të lëndës drusore, të dhëna të kadastrës pyjore për ndryshime të mundshme gjatë 30-40 viteve të shkuara, si dhe hartat respektive për këtë ekonomi pyjore etj.
- ✓ Kryerja e rëlvimeve silvikulturore e dendrometrike në terren në sipërfaqet provë të përherëshme dhe të përkohëshme si dhe marrja e informacionit të nevojshëm nga popullatat vendore dhe hedhja e tyre në skedat e përshkrimit dhe inventarizimit të parcelës ose nënparcelës të materializuar në terren.
- ✓ Ndarjen e parcelave dhe nënparcelave në hartë dhe materializimin e tyre në terren, vendosjen e numrave respektive të tyre, grumbullimi i informacionit lidhur me të dhëna për tokën, klimën dhe druret model etj.

Në vijim është vazhduar me punimet e zyrës, kompjuterizimin e të dhënave të përshkrimit parcelar si dhe të inventarizimit të sipërfaqeve provë të përhershme e të përkohëshme, matjen e sipërfaqeve të parcelave dhe n/parcelave, përgatitjen e raporteve përkatëse.

Detyra e projektimit kishte për qëllim hartimin e planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore “Dardhe Qebik”, që do të fillonte me kryerjen e rilevimeve në teren, plotësimin e skedave përkatëse, grumbullimin e gjithë informacionit të nevojshëm, përpunimin e të dhënave në zyrë dhe përpilimin e materialit hartografik, duke zbatuar me korrektësi manualin e ri të mbarështimit të pyjeve. Kjo ka qënë detyra e projektimit dhe njëkohësisht detyrimi kontraktual për “Deja” shpk me qendër në Tiranë, që u angazhua me hartimin e planit të mbarështimit të kësaj ekonomie.

Kjo është përcaktuar në detyrën e dhënë nga MTM (Drejtoria e Politikave të Pyjeve e Kullotave) dhe Drejtorise Pyjeve bashkia Fushe Arrez për hartimin e planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore që kanë kaluar këto afate dhe që kanë ndryshime të theksuara në strukturë dhe në bonitet.

Puna për marrjen e informacionit të nevojshëm në terren ka filluar në Maj 2025 dhe ka përfunduar në Gusht 2025. Periudha në vijim ka shërbyer për kryerjen e punimeve të zyrës në përpilimin e relacionit të planit të mbarështimit.

Në hartimin e planit të mbarështimit janë pjesëmarrës disa aktorë me përgjegjësi dhe role si më poshtë:

Bashkitë (BA): Janë pronarët legjitime dhe administratorët e pyjeve dhe kullotave brenda territorit të tyre. Administrimi i pyjeve dhe kullotave kryhet nëpërmjet strukturave përgjegjëse për pyjet në Bashki dhe menaxhimi i tyre deri tani është kryer mbështetur në planet ekzistuese të mbarështimit. Aktualisht, shumica e planeve të mbarështimit të pyjeve në pronësi të bashkive kanë tejkaluar afatet e vlefshmërisë, prandaj ka një nevojë urgjente për hartimin e planeve të reja të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave

Roli kryesor i Bashkisë në këtë proces është:

- përcaktimi i kriterëve për përcaktimin e Ekonomisë pyjore/NJM
- përcaktimi i nevojave për përgatitjen e planit të ri të pyjeve dhe kullotave bazuar në kriterin e urgjencës
- alokimi ose aplikimi për fonde me qëllim përgatitjen e PMPK dhe drejtimi i procesit të hartimit të planit të mbarështimit që nga nënshkrimi i kontratës deri në monitorimin final.
- sigurimi i informacionit për Kadastrën Pyjore në lidhje me të dhënat e parcelave dhe nënparcelave tek SISP.
- përcaktimi me bashkitë fqinje i nevojave për rregullimin e kufijve të ekonomive pyjore nëse është e nevojshme duke respektuar kufijt sipas ndarjes së re administrative.
- organizimi dhe menaxhimi i procesit të pjesëmarrjes së aktorëve ose palëve të interesuara (pronarë, komunitet, përdorues pyjesh, shoqata të përdoruesve të pyjeve, OJF).
- transmetimi i të dhënave të monitorimit të përvitshëm të ndërhyrjeve dhe ngjarjeve tek SISP dhe tek institucionet e tjera (AKM, MTM).

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) : MTM është përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave të Kadastrës Pyjore, Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe SISP. Ajo menaxhon integrimin e informacionit të planeve aktuale që janë të vlefshme dhe të planeve të reja të

mbarështimit të pyjeve dhe kullotave të përgatitura për çdo Bashki në SISP. MTM bën miratimin final të PMPK, pasi bashkia ka bërë miratimin apo mbështetjen nga ana e saj.

Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP). AKP është nën varësinë e MTM dhe ka përgjegjësi për menaxhimin dhe monitorimin e Inventarit Kombëtar të Pyjeve (IKP) (nëpërmjet sektorit të inventarizimit të pyjeve), të gjithë fondit pyjor dhe kullësor, biodiversitetit, të dhënat e mbulesës së tokës dhe të ndryshimit të saj (nëpërmjet sektorit të Silvikulturës dhe Biodiversitetit). Bazuar në VKM Nr 47, datë 29 Janar 2014, AKP është përgjegjëse për zhvillimin e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave si dhe ruajtjen apo monitorimin e të dhënave të këtyre planeve.

Këta janë aktorët direkt përgjegjës në procesin e përgatitjes dhe menaxhimit të PMPK. Por ka edhe disa aktorë të tjerë të rëndësishëm të përfshirë në këtë proces të quajtur aktor kyç si:

Organizatat Jo Fitimprurëse (OJF): Shoqatat e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave janë të organizuara në nivel lokal dhe mbrojnë interesat e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave në zonat rurale në Shqipëri dhe bëjnë kordinimin midis përdoruesve. Ato mbështesin zbatimin e aktiviteteve të planifikuara në kuadër të planit të mbarështimit të pyjeve e kullotave në nivel Njësie Administrative. Këto shoqata janë të organizuara në nivel rajonal dhe kombëtar duke formuar Federatën Rajonale dhe Kombëtare të Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave, e cila është një organizatë jofitimprurëse dhe joqeveritare që mbron dhe përfaqëson interesat e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave në zonat rurale në Shqipëri.

Fakulteti i Shkencave Pyjore (FSHP): Fakulteti i Shkencave Pyjore është institucioni i vetëm i edukimit universitar në fushën e pyjeve. Ai ofron trajnim për specialistët e pyjeve në përgjithësi, shpërndarje të informacionit, harton manuale për zbatimin shkencor të aktiviteteve të planifikuara si dhe asistencë për hartimin e udhëzuesit të planeve të mbarështimit.

Organizata të tjera të rëndësishme në nivel lokal dhe kombëtar të përfshira në proces si aktore kyç janë: Organizatat e Grave, të mjedisit, të menaxhimit të biznesit lokal, etj.

1.3 Metodologjia e Punës.

Metoda e punës e zbatuar për hartimin e planit të mbarështimit është mbështetur në zbatimin e motivuar të manualit të ri të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave (2019), ku përshkruhen qartë udhëzimet për përshkrimin parcellar, udhëzimet për inventarizimin me sipërfaqe provë si dhe udhëzimet për punimet e zyrës. Ky udhëzues është zbatuar me disiplinë e korektësi të lartë teknike në të gjitha fazat e punës.

Për punimet e terrenit nuk ka pasur tejkalim të limitit të sipërfaqes së parcelës, kurse për inventarizimin me sipërfaqe provë distancat e matura në teren (rezja, distanca e qendrave të sipërfaqeve provë etj) janë reduktuar në përputhje me pjerrësinë e terrenit.

Secila sipërfaqe provë përbëhet nga 3 sipërfaqe rrethore bashkëqendrore me madhësi 25 m², 200 m² dhe 400 m². Kjo formë e organizimit të sipërfaqeve provë synon që të mbulojë variacionin e diametrave në grumbullin pyjor.

- Sipërfaqja e parë rrethore me madhësi 25 m² ($r = 2.82$ m) shërben për matjen e rigjenerimit, drurëve me diametër bazimetrik (1.3 m nga toka) nga 2.0 - 7.5 cm, vlerësimin e produkteve jo-drusore dhe inventarizimin e kullotave

- Sipërfaqja e dytë rrethore me madhësi 200 m^2 ($r = 7.98 \text{ m}$) shërben për matjen e drurëve me diametër bazimetrik nga 7.51 deri 27.5 cm.
- Sipërfaqja e jashtme rrethore me madhësi 400 m^2 ($r = 11.28 \text{ m}$) shërben për të matur drurët me diametër bazimetrik $> 27.5 \text{ cm}$.

Si gjatë rlevimeve të terrenit ashtu edhe gjatë punimeve të zyrës nuk ka pasur shmangie nga metodologjia standarte e mbarështimit.

1.4 Informacioni i përdorur në hartimin e PMPK

Materiali bazë për grumbullimin e informacionit është plani i vjetër i mbarështimit të ekonomisë pyjore Dardhe Qebik, hartat topografike e tematike të kesaj zone, ortofoto (imazhe) satelitore, informacioni respektiv i mbledhur nga personeli pyjor i bashkisë, nga fshatarët e kësaj treve, tabelat e prodhimit (kubaturës), projekte e studime shkencore të kryera nga specialistë të ish D.SH.P. Fushe Arrez dhe institucione të tjera projektuese e studimore. Informacioni është grumbulluar në terren për llojet, dendësinë e grumbullit, nën-pyllin, bimesinë, nga matjet e realizuara sipas rrjetit kuadratik $200 \times 200 \text{ m}$, etj.

Gjithashtu ekspertet përgjegjës për hartimin e planit të mbarështimit grumbulluan edhe dokumentacion shtesë në lidhje me:

- Planin e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë i ashtuquajtur "Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Fushe Arrez"
- Informacion mbi të dhënat demografike, të drejtat e përdorimit, tregjet lokale të produkteve drusore dhe jodrusore, kullosore etj.
- Informacion mbi turizmin, edukimin dhe aktivitetet rekreative

I gjithë informacioni do të shërbejë për të kryer një studim paraprak të ekonomisë pyjore që përmban:

- shtrirjen, kufijte dhe sipërfaqen e përgjithshme të ekonomisë pyjore dhe kullosore
- karakteristikat e përgjithshme të fondit pyjor (sipërfaqja e veshur me pyll dhe kullota; llojet drusore përbërës; klasat e moshës; gjendja e grumbujve pyjor; rrugët që përshkojnë ekonominë pyjore, etj.)
- të dhëna të tjera të nevojshme për ekonominë dhe hartat pyjore.

2 PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I EKONOMISË

2.1 Informacioni i përgjithshëm rreth Ekonomisë pyjore

Ekonomia pyjore Dardhe Qebik shtrihet në territorin e bashkisë Fushe Arrez dhe aktualisht administrohet nga kjo bashki, dikur administrohej nga DSHP Fushe Arrez. Planin e mbarështimit është i vlefshëm për periudhën kohore nga 2025 deri 2034. Planin e ri të mbarështimit hartohet sepse nuk ka patur plan të mirefillte mbarështimi, gjithashtu planin e vjetër të mbarështimit është hartuar në vitin 1987 dhe ka qënë i vlefshëm deri 1997. Një tjetër arsye është se bashkia Fushe Arrez ka siguruar mbështetje financiare për hartimin e planeve të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave në territorin e saj.

Ekonomia pyjore është me të njëjtin emër dhe ka patur një sipërfaqe totale prej **3898.45** ha, ndërsa me planin e ri dhe ndarjen e re territoriale kjo sipërfaqe arrin në **4308.3** ha.

Përshkrimi i përgjithshëm i ekonomisë ka për qëllim njohjen dhe evidentimin e problemeve teknike dhe sociale të mprehta të zonës ku do të kryhet mbarështimi, në mënyrë që të gjejnë pasqyrim në objektivat e mbarështimit për të ardhmen.

Mbarështimi i grumbujve pyjor të ekonomisë pyjore Dardhe Qebik ka synuar dhe synon që nëpërmjet zbatimit të një silvikulture natyralistike të garantojë strukturën shumëmoshare të grumbujve, të ruaj biodiversitetin në përputhje me karakteristikat ekologjike stacionale, të sigurojë vijueshmërinë e prodhimeve të pyllit dhe veçanërisht ripërtëritjen natyrore dhe shumëfunksione të grumbujve pyjorë.

2.2. Pronësia, administrimi dhe organizimi

Referuar të dhënave të grumbulluara gjatë takimeve nëpër njësitë administrative, rezulton se deri në vitin 1944 pyjet dhe kullotat, që shtrihen në territorin e kësaj ekonomie, kanë qënë pronë shtetërore, ndërsa të drejtën e përdorimit e kishin vetë fshatarët, për marrjen e materialit drusor, për nevojat e tyre, nga pylli i përbashkët i fshatit ose nga pylli që kishte në përdorim një familje ose fisi.

Pas këtij viti, të gjithë pyjet dhe kullotat u shtetëzuan. Për plotësimin e nevojave të tyre me dru zjarri, lëndë ndërtimi dhe gjeth për blegtorinë, banorët e fshatrave duhej të mernin lejen e organeve shtetërore.

Pyjet dhe kullotat e ekonomisë pyjore Dardhe Qebik, gjatë periudhës 1944-1990 janë administruar nga shteti, nëpërmjet strukturave të tij. Po gjatë kësaj periudhe pyjet janë shfrytëzuar nga vetë shteti dhe nga banorët e fshatrave në afersi të tyre.

Nga sa më sipër rezulton se e drejta e përdorimit të pyjeve dhe kullotave ka evoluar sipas etapave të ndryshme.

Në vitin 1995, me vendim Qeverie, në kuadrin e decentralizimit të pronësisë shtetërore një pjesë e kullotave kaluan në administrim të pushtetit vendor, ndërsa procesi i kalimit të pyjeve në përdorim të Njësisë të qeverisjes vendore, filloi në vitin 1997, së bashku me kullotat e përfshira brenda fondit pyjor.

Së fundmi, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 134 datë 03.03.2021, Komuna që bën pjesë në ekonominë pyjore Dardhe Qebik kanë marrë në pronësi pyje dhe kullota brenda territorit të saj.

Me reformën administrative dhe ndarjen e re territoriale në vendin tonë pasuritë pyjore dhe kullosore kaluan në pronësi dhe administrim të bashkive, konkretisht të bashkisë Fushe Arrez me VKM. Nr 134 datë 03.03.2021. Pra, me këtë veprim, e drejta e pronësisë është transferuar nga qeverisja qendrore në atë vendore, e cila do t'u japë ato në përdorim banorëve të fshatrave të saj. Nga dhënia e pyjeve në përdorim të komuniteteve, do të garantohet ruajtja dhe zhvillimi i pyjeve dhe kullotave. Kështu që roli kryesor për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave do t'u kalojë banorëve vendas, ndërsa personeli pyjor do të ketë rolin këshillimor dhe kontrollues.

Ekonomia pyjore Dardhe Qebik, Fushe Arrez është në pronësi publike. Ajo administrohet nga Bashkia Fushe Arrez dhe shtrihet brenda kufijve natyrorë të kësaj bashkie. Dikur kjo ekonomi pyjore ka qënë administruar si pronë shtetërore nga ish-DSHP Fushe Arrez.

Ekonomia pyjore Dardhe Qebik shtrihet në 1 Njësi Administrative, ajo Blerim ku përfshihen fshatrat: Mezi, Dardhe, Trun dhe Qebik.

Njësia administrative, ndodhet në një distancë prej 30 km larg nga qyteti i Fushe Arrezit. Një pjesë e rrjetit rrugor përshkon një pjesë të parcelave pyjore. Vjelja e lëndës drusore ka kosto shumë të lartë, kushtet e punës janë shumë të vështira si dhe mungojnë punëtorët e kualifikuar në profesionin e shfrytëzimit të pyjeve.

Përveç prodhimeve drusore, gjethit dhe barit, nga pyjet dhe kullotat, grumbullohen bimë të ndryshme mjeksore. Nga viti në vit sasi të grumbulluara kanë ardhur në rënie. Megjithatë ato përbëjnë një burim të vogël të ardhurash për banorët e fshatrave të kësaj zone.

Çmimet e liberalizuara në treg për 1m³ lëndë e rrumbullakët (trup) variojnë nga 8000-10000 lek, kurse 1m³ lëndë e sharruar (dërrasë) kushton 18-20 mijë lek. Për 1m³ dru zjarri të forta çmimi në pikat e shitjes me shumicë varion nga 3500 - 5000 lek.

Në ekonomi ekzistojnë të drejtat e përdorimit si më poshtë:

- ✓ E drejta e përdorimit për kullotje.
- ✓ E drejta e përdorimit për grumbullim bazë ushqimore për blegtorinë, për dimër.
- ✓ E drejta e përdorimit për të prodhuar dru zjarri dhe lëndë drusore për ndërtim.

Në të gjitha rastet këto të drejta përdorimi u përkasin banorëve të kësaj krahine. Përsa i takon problemeve të pronësisë si për kullotat ashtu edhe për pyllin nuk ekzistojnë konflikte ndërmjet banorëve vendas, ka një ndarje pak a shumë të stabilizuar midis pronësive publike dhe asaj private. Sipërfaqja e pyjeve për prodhim gjethi është ndarë në bazë fisesh (familjesh) edhe pse kjo nuk ka bazë ligjore dhe nuk është bërë nga shërbimi pyjor.

2.3 Vendodhja gjeografike dhe ndarja administrative

Ekonomia pyjore Dardhe Qebik shtrihet në Veri të Bashkisë Fushe Arrez, ajo përfshihet në pellgun ujëmbledhës të lumit Drin në Liqenin e Fierzes që derdhet me tej Koman, Vau i Dejes dhe detin Adriatik. Ky pellg përbëhet nga bazenet ujëmbledhëse të faqeve të Dardhes dhe të Qebikut.

Në **Veri**: Liqeni I Fierzes.

Në **Lindje**: Maja e Shalcit 533 m, kullotat 608m, 649m, kodra e Sakatit 815 m, Maja e Shenjave 1277m, Qafa e Klyzeve 1207 m.

Në **Jug**: Qafa e Klyzit, Maja e Malit 1668 m, shpati i Kunores 1580m, Maja e Kunore Dardhe 1584 m,

Në **Perëndim**: Maja e Laknishtes 1393 m, kuota 1127 m, Qafa e Ujit 1060 m, Boka e Dardhes 813 m, fshati Mezi, liqeni i Fierzes

Ekonomia përfshihet në hartën me shkallë 1: 25000 me nomenklaturë:

K-34-65-C-a; K-34-65-A-d; K-34-65-C-b

Perimetri i ekonomisë pyjore “Dardhe Qebik” kufizohet nga këto ekonomi pyjore në:

Veri.: Liqeni i Fierzes

Lindje: Ekonomia Pyjore Sakat Lak Hithi

Jug: Ekonomia Pyjore Sakat Lak Hithi

Perëndim: Ekonomia pyjore Kryezi dhe Iballe Mezi

2.4 Konteksi i Bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore

Në territorin e Bashkisë Fushe Arrez, pyjet dhe kullotat, menaxhohen nëpërmjet ekonomive pyjore, si njësi bazë pyjore në terren, për të cilat, janë hartuar Planet e Mbarështimit.


Sipas pozicionit Gjeografik të Ekonomisë në studim, brenda sipërfaqes totale ndodhet vetëm një Njësi Administrative ajo Blerim konkretisht fshatrat Mezi, Dardhe, Trun dhe Qebik.

Plani i Mbarështimit nga përpunimi i të dhënave të marra në terren jep një tablo të qartë të gjendjes dhe konsistencës së pyjeve përmes sipërfaqes, tipit të grumbujve pyjore dhe të përdorimit të territorit dhe veçanërisht të strukturës së pronësisë. Grupet e punës gjate gjithë kohës ishin në kontakt me komunitetin që banon dhe kryen veprimtarinë e tij lidhur me pyllin dhe mjedisin pyjor, duke i përfshirë ata në diskutim dhe planifikim dhe vendimarrje, për të realizuar menaxhimin me pjesënarrje të komunitetit.

Ekonomia pyjore ka një sipërfaqe të përgjithshme prej **4308.3** ha dhe sipas përdorimit të territorit ka këtë strukturë :

Tab.2.4.1

Nr	Emërtimi	Sipërfaqja ha viti 2025
1	Pyje gjithsej	3606
2	Kullota livadh	21.3
3	Sipërfaqe me bimësi pyjore	306.2
4	Djerr	3
5	Jo produktive	0.9
6	Urbane	4.4
8	Bujqësi	366.6
	Shuma	4308.3



Pyjet me funksion prodhues zënë 3606 ha ose 100 % të sipërfaqes.

Grumbujt pyjore të kësaj ekonomie qeverisen si më poshtë:

- ❖ Pyjet trungishte zënë 1845.5 ha ose 51.2 % të sipërfaqes pyjore,
- ❖ Pyjet cungishte zënë 939.9 ha ose 26.1 % të sipërfaqes pyjore,
- ❖ Pyjet trungishte e parreg. zënë 557.8 ha ose 15.5 % të sipërfaqes pyjore,
- ❖ Pyjet cungishte e perbere zënë 262.8 ha ose 7.3 % të sipërfaqes pyjore.
- ❖ Kullotat zene nje siperfaqe prej 21.3 ha

Nisur nga te dhenat e mbuleses se tokes ne ekonomine pyjore Dardhe Qebik, kemi edhe teritore te tjera qe rezultojne te kene nje siperfaqe te pergjitheshme prej **681 ha**.

Te dhena me te hollesishme jepen ne tab.2.5.1

Nisur nga të dhënat e tabelës 2.4.1 rezulton se ekonomia pyjore Dardhe Qebik, ka një sipërfaqe totale prej **4308.3 ha**

Për përmiresimin e vazhdueshëm të gjendjes së pyjeve jane propozuar masa konkrete në drejtim të rritjes së prodhimit të grumbujve pyjore, përdorimit optimal të stacionit, sigurimit të gjeneratës së re në rrugë natyrore dhe artificiale, ruajtjes të biodiversitetit të florës e faunës, mbrojtjes të pyjeve nga zjarret dhe prerjet e paligjshme, rehabilitimit të infrastrukturës rrugore, krijimit të tregut të punës dhe më kryesorja përfshirja e popullatës lokale në vendimmarrjet kryesore për mbarështim të qëndrueshëm të ekonomisë pyjore.

Mbarështimi i ekonomisë pyjore Dardhe Qebik, nga stafi i projektit në përgjithësi është realizuar në kushte relativisht të përshtatshme pune si për rëlevimet e terrenit ashtu edhe ato të zyrës.

Punimet e terrenit filluan në përputhje me grafikun e hartuar për këtë qëllim dhe për përfundimin në kohë të tyre u angazhua grupi punës në përbërjen e të cilit merrnin pjesë 3 inxhinier pyjesh.. Për të garantuar përfundimin e punimeve brenda afateve të kontratës është punuar në terren me orar të zgjatur, që i kalonte 8 orët në ditë. Fale mbështetjes logjistike në dispozicion lëvizja e stafit për në ekonomi edhe brenda saj në shumicën e rasteve është bërë me mjete të kompanisë dhe në këmbë.

Studimi i biodiversitetit të florës dhe faunës së ekonomisë është bërë nga një grup i specialistëve të përbërë prej botanistësh e zoologësh, të cilët punojnë në institucionet shkencore të Tiranës.

Pajisjet e përdorura nga grupi i punës në teren për kryerjen e rëlevimeve të mbarështimit janë modeste; GPS, vërtex, tablet, hipsometër Blume-leiss, busulla, tryela Pressler, diametra matës, metër shirit, rrjeti i sip. provë me koordinatat përkatëse dhe harta të printuara në format A3, etj.

2.5 Historiku i Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave në Ekonominë Pyjore

Mbarështimi i vitit 1987 është kryer, me inisiativën e specialistëve të ish ndërmarrjes së pyjeve të rrethit dhe me asistencën teknike të Stacionit të Pyjeve e Kulturave Eterovajore. Ndërsa mbarështimi i pjesëve të vecanta të kësaj ekonomie është bërë gjatë viteve 2000-2010 me mbështetje financiare të Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore, në kuadër të projekteve komunale. Mbarështimi i fundit i ekonomisë pyjore Dardhe Qebik është realizuar në vitin 2025 me financimin e bashkisë Fushe Arrez.

Të dhënat paraqiten në tab.2.5.1

Tab.2.5.1 Përdorimi i Territorit (krahasimi 1987 me 2025 pa përfshirë shtesat në sipërfaqe.)

Nr	Përdorimi	Viti 1987		Viti 2025			
		ha	%	Shtesat e pakësimit		Totali	
				ha	%	ha	%
1	Pyje total	3551.25	91.1	+54.75	+14.08	3606	83.7
2	Kullota-Livadhe	9.7	0.2	+11.6	+2.83	21.3	0.49
3	Sip. me bimësi pyjore	337.5	8.66	-31.3	-7.63	306.2	7.12
4	Djerr (eroduar)	0		+3	+0.73	3	0.07
5	Joproductive	0		+0.9	+0.22	0.9	0.02
6	Urbane	0		+4.4	+1.07	4.4	0.1
8	Tokë bujqësore - Urbane	0		+366.6	+89.4	366.6	8.51
	Totali	3898.45	100	+409.95	100	4308.3	100

Ndryshimet në rritje të sipërfaqes së ekonomisë kanë ardhur për këto arsye.

1. Pakesimimi i sipërfaqes pyjore ka rezultuar nga zjarret dhe prerjet abuzive mbas vitit 1997 ku një pjesë e mirë e pyjeve aktualisht kanë përfunduar në sipërfaqe me bimësi pyjore, një shtesë e konsiderueshme rezulton nga përfshirja e parcelave të ekonomisë bujqësore në këtë ekonomi pyjore dhe shtimi i sipërfaqes pyjore nga pyllëzimet. Njëkohsisht në këtë ekonomi nuk kanë qenë përfshirë të gjitha tokat e bukës dhe trojet dhe as sipërfaqet ujore.

Për shkaqet e sipërcituara shtesat rezultojnë si më poshtë:

- Pyje +54.75 ha
- Kullota +11.6 ha
- Sip.b. pyjore -31.3 ha
- Djerr +3 ha
- Joproductive +0.9 ha
- Urbane +4.4 ha
- Bujqësi + 366.6 ha
- Ne total + **409.95** ha

a-Më konkretisht shtesa prej 54.75 ha pyje rezulton nga shtimi i sipërfaqeve pyjore nga sipërfaqet me bimësi pyjore dhe në anë të masiveve.

b- Shtesa prej 11.6 ha kullota rezulton nga evidentimi me i sakte i tyre.

c- Pakesimi prej 31.3 ha sipërfaqe me bimësi pyjore rezulton nga kalimi i sipërfaqes me bimësi pyjore në pyje dhe kullota.

d-Shtesa prej 3 ha djerr, 0.9 ha inproductive, 4.4 ha urbane dhe 366.6 ha bujqësi rezulton nga mos evidentimi korrekt i këtyre sipërfaqeve në vitin 1987 dhe evidentimi me korrekt aktualisht.

2. Brenda territorit të ekonomisë janë pasqyruar në këtë sipërfaqe dhe sipërfaqet aktuale që përdoren për toka buke dhe troje (urbane), etj.
3. Nga rezultatet e matjeve sipas GIS që mendojmë se sot kryhet me metoda më të sofistikuar e të sakta pothuajse në të gjithë ngastrat e ekonomisë rezultati del më i madh se sipërfaqet e mëparëshme.
4. Sipas kalkulimeve në GIS rezulton që shtesa totale në sipërfaqe prej **409.95** ha rrjedh nga këto arsye që përmendëm më lart.

Sqarojmë se përvec shtimit në sipërfaqe fondi pyjor i kësaj ekonomie ka ndryshime të theksuara qoftë në strukturën e grumbujve dhe në volum. Kjo ka ardhur për arsye të një ndryshimi tepër të madh nga pakesimi i sipërfaqes pyjore nga zjarret dhe prerjet abuzive, të ripërtëritjes së masiveve të shfrytëzuara para viteve 90, instalimi i pyjeve në sipërfaqet kullosore dhe të xhveshura etj.

Mbështetur në Inventarizimin e vitit 1987 krahasuar me mbarështimin e vitit 2025, rezulton të kemi një sipërfaqe pyjore të shtuar prej 54.75 ha

Ndërsa përsa i përket formës së qeverisjes pyjet trungishte janë 1845.5 ha, cungishte 939.9 ha, trungishte e parregullt 557.8 ha dhe cungishte e perbere 262.8 ha.

Vlen të theksohet se kjo ekonomi është shfrytëzuar mbi mundësinë vjetore duke prodhuar një sasi të konsiderueshme lëndë drusore, dru zjarri për nevojat e popullatës, pasi ka qënë me rrjet rrugore dhe afër qendrave të banuara. Ndikim negativ në këtë aspekt ka patur edhe periudha e tranzicionit, gjatë së cilës është prerë sidomos lënda e punimit, që ndodhej afër rrugëve auto. Në mbarështimin aktual është përcaktuar qartë që funksioni kryesor i ekonomisë të jetë ai prodhues.

Ekonomia pyjore ka një sipërfaqe totale prej 4308.3 ha nga e cila 3606 ha ose 83.7 % janë pyje dhe 21.3 ha ose 0.49 % janë kullota.

Pyjet me funksion prodhues zënë një sipërfaqe prej 3606.2 ha ose 100 % të sipërfaqes pyjore. Në të ardhmen propozohet që pyjet prodhues të zënë 3606.2 ha ose 100 % të sip.pyjore.

Periudha e vlefshmërisë së planit të mëparshëm të mbarështimit kishte përfunduar qysh në vitin 1995 dhe duhet të theksojmë se janë kryer fare pak ndërhyrje silvikulturale të planifikuara për mungesë financimi. Ndërsa nga banorët e zonës është shfrytëzuar lëndë drusore për prodhimin e druve të zjarrit.

2.6. Situata demografike dhe social-ekonomike

Popullsia vendore në këtë ekonomi është në një gjendje social - ekonomike jo të kënaqëshme edhe pse kanë aq afër pyje e kullota të shumta. Pylli aktualisht është një burim jetese për popullsinë që jeton në brendësi dhe në afërsi të ekonomisë. Dëmtime të ndjeshme kanë pësuar pyjet e kësaj ekonomie sidomos në periudhën e zgjatur të tranzicionit. Sasia e lëndës drusore, që është prerë nga vendasit është shitur në kushtet e ekonomisë së tregut. Ajo e ka përmirësuar gjër në një farë mase aspektin social-ekonomik të banorëve vendas por nuk e ka zgjidhur problemin e varfërisë. Të ardhurat e siguruar në këtë linjë janë thithur nga ajo pjesë e familjeve që janë zhvendosur për në zonat urbane. Pra si konkluzion mund të themi se të ardhurat e banorëve, që aktualisht banojnë në këto fshatra mbeten në nivele të ulta - deri mesatare. Shtimi i të ardhurave të tyre mund të bëhet vetëm me investime të mundëshme në përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale si edhe në sektorin e pyjeve dhe turizmit.

Të dhëna për fshatrat dhe popullsinë;

Popullsia e këtyre fshatrave dikur (10 vjet më parë) përbëhej nga 153 familje me rreth 612 banorë dhe 241 krahë pune, po e njëjta gjë reflektohet edhe aktualisht. Nga këto fshatra ka akoma lëvizje të popullatës për tu vendosur në qendra të mëdha urbane. Lëvizjet e vrejtura janë ato të emigracionit, që është në shkallë mjaft të lartë dhe rinia përbën pjesën më të madhe të të larguarve, jo vetëm në fshatrat e zonës por edhe në gjithë bashkinë. Mungesa e një pune të qëndrueshme dhe afat-gjatë përbën një nga shkaqet e këtij largimit. Burrat merren

kryesisht me punët e rënda të bujqësisë dhe ruajtjen e blegtorisë së imët (veçanërisht dele e dhi), ndërsa gratë merren me shumë me punimin e kopshteve për prodhimin e perimeve dhe mbareshtimin e gjedhit (lopes), si dhe punët në shtëpi. Me mbjelljen dhe krasitjen e pemëve frutore si dhe me tregtimin e prodhimeve merren më shumë burrat, kurse grate me pak. Një pjesë e mirë e banoreve të zonës arrijnë të shesin prodhimet bujqësore dhe blegtorale si mishi, gjalpi, djath etj. Drutë e zjarrit prodhohen apo sigurohen si nga gratë ashtu edhe nga burrat, por nuk mungojnë rastet që këto punë bëhen dhe nga fëmijet.

Në ekonominë Dardhe Qebik ushtrojnë aktivitet disa biznese private si lokale, dyqane e bujtina.

Aktualisht numuri i familjeve është 153 me 612 banorë rezident. Të dhëna më të hollësishme demografike jepen në pasqyrën në vijim:

Të dhëna demografike dhe tokës bujqësore Pasqyra nr.2.6.1.

Nr	NJ/A	Familje	Banorë			Krah pune	Tokë bujqësore (ha) për :		
			Gjithsej	Femra	Meshkuj		Gjithsej	Familje	Banorë
	Totali	153	612	306	306	241	219	153	612

Numri i femrave dhe meshkujve është respektivisht 306 dhe 306, ndërsa raporti ndërmjet tyre është 50 % me 50 %. Nga numri total i popullsisë, 612 banorë, ose 39 % e numrit total, janë të aftë për punë.

Nga numri total i familjeve prej 153 trajtohen me ndihmë ekonomike 14% e tyre .

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme dhe konkretisht numrit të familjeve dhe të banorëve, sipërfaqja e tokës bujqësore, për familje dhe për banor, rezulton respektivisht 1.43 ha dhe 0.36 ha.

Të dhëna mbi blegtorinë

Në fshatrat e ekonomisë pyjore Dardhe Qebik, banorët mbarështojnë gjithsej 460 krerë, nga të cilat 220 krerë dhi, 80 krerë dhen, 110 krerë lopë dhe 50 njëthundrake.

Tab. 2.6.2

Nr.	NJ/A	Të dhëna për blegtorinë					Prodhimi (Ton)	
		Dhen	Dhi	Gjedhe	Një thundrak	Bletë	Qumesht	Mish
	Totali	80	220	110	50	440	16	2

Prodhimi i qumështit në vit është 16 ton dhe për frymë është 26.1 kg në vit ose 0.07 në dit, ndërsa i mishit 2 ton ose 3.26 kg në vit ose 0.009 kg në dit. Duhet patur në konsideratë se jo e gjithë sasia e qumështit përdoret për konsum ditor, pasi një pjesë e tij përdoret për prodhimin e nënprodukteve të tij si djath, gjizë etj.

Nga të dhënat e Tab. 2.6.2 rezulton se në këto fshatra mbarështohen një numër i konsiderueshem krerë bagëti që bazën ushqimore e kanë dhe në ekonominë pyjore Dardhe Qebik, kullotat përdoren nga blegtorët gjatë gjithë vitit, po ashtu ata përdorin edhe pyjet me

shkurre rreth fashatrave për kullotë. Kjo mënyre mbarshtimi e blegtorisë nuk është vetëm për motive të traditës, por detyrohet edhe nga mungesa e tokës bujqësore për kultivimin e foragjereve. Produktet blegtorale tregtohen kryesisht në Fushe Arres dhe zonat me aktivitet të zhvilluar turistik të qarkut.

Përdorimi i tokës bujqësore

Të dhënat për bujqësinë jepen në *pasqyrën nr. 2.6.3* dhe siç shihet kulturat bujqësore që zënë sipërfaqen më të madhe të kultivuar janë drithrat, të ndjekur nga pemtaria dhe në fund vjen vreshtaria.

Pasqyra 2.6.3 . Përdorimi i tokës bujqësore.

Nr.	NJ/A	Sipërfaqja e tokës bujqësore dhe përdorimi i saj (ha)						
		Gjithsej	Truall	Arë	Pemtore	Vreshta	Ullishta	Aband.
	Totali	366	146	180	30	10	-	-

Problem mbetet vaditja e kulturave bujqësore e foragjere pasi kërkon investime në kanalet vaditës.

Tokat e abandonuara

Nga konsultimet me banorët e fshatrave, u arrit në perfundimin se ato mund të përdoren përsëri. Konkretisht është kërkuar që këto sipërfaqe të pyllëzohen. Ne mendojmë, se do të qe me vlerë, që të kryhet një studim i mirëfilltë për mbjelljen e drufrutorëve dhe atje ku këto kultura nuk shkojnë për ndonjë arsye, të shikohet mundësia për mbjelljen e llojeve pyjorë dhe kryesisht arrore .

Prodhimet pyjore që përdoren zakonisht

Ndër prodhimet pyjore që përdoren në mënyrë të përditëshme nga banorët e fshatrave të kësaj zone janë drutë e zjarrit. Prodhime të tjera janë lënda e ndërtimit dhe gjethi për blegtorinë, përdorimi i të cilave nuk është gjithëvjeter.

Për të krahasuar nevojat e banorëve për prodhime pyjore, dru zjarri dhe lëndë ndërtimi, është llogaritur mundësia vjetore e shfrytëzimit, për të gjithë sipërfaqen e pyjeve. Në total nga ndërhyrjet silvikulturore mundësohet vjelja e 5265 m³ në vit. Me këtë sasi materiali plotësohen nevojat e popullatës së zonës me dru zjarri, ndërsa lëndën e punimit duhet ti sigurojnë nga tregu.

Drutë e zjarrit përdoren kryesisht për gatim, ngrohje dhe larje. Ato sigurohen nga pyjet. Nevojat mesatare për një familje llogariten minimalisht 5 m³/vit ose rreth 8.35 mst/vit.(7 muaj).

Pyjet prodhues zënë 100 % të sipërfaqes pyjore dhe 100 % të volumit të përgjithshëm, nga këto pyje do të sigurohen drutë e zjarrit.

Duke patur parasysh se pyjet trungishte dhe cungishte janë në pjesën më të madhe pyje halor dhe fletorë ku haloret nuk mund të shfrytëzohen për këtë qëllim, kështu që sasitë më të mëdha të nevojave për dru zjarri do të sigurohen nga dushqet cungishte dhe prerjet silvikulturore ne fletorë kurse druret e zjarrit dhe levorja qe rezultojnë nga ndërhyrjet në halore mund te përdoren në nevojat industriale.

Tab.2.6.5 Konsumi vjetor për drutë e zjarrit dhe burimet e tjera të energjisë

Njësia	Nr. familjeve	Dru zjarri (m3)		Burime të tjera		
		Për familje	Total	Qymyr (kv)	Energji elektrike (kw/ore)	Gaz (litra)
Ek. Pyjore	153	5	765	0	496800	1704

Lënda e ndërtimit përdoret për ndërtimin dhe riparimin e shtëpive, stallave etj. Mesatarisht janë llogaritur rreth 0.1 m³ lëndë ndërtimi për çdo familje në vit, që do të thotë afërsisht nga 15 m³ në vit. Nevojat për këtë produkt plotsohen nga pyjet e kësaj ekonomie pyjore..

Grumbujt pyjor të ekonomisë si trungishtet po ashtu edhe ato cungishtet janë kryesisht në masë të konsiderueshme një katësh. Kjo për faktin se prej tyre vazhdimisht janë marrë dru zjarri, duke prerë drurët me dimensione të vogla dhe shkurret, brenda sipërfaqes së parcelës, pa përjashtuar edhe prerjen e durëve të mëdhenj.

Në tipet e grumbujve sipas shkallës së homogjenitetit mbizotrojnë grumbujt johomogjen. Shih pasqyrat.

7.1.4 Cilësia e materialit drusor

Nga të dhënat e Sip.provë dhe vrojtimet e kryera në terren rezulton se në trungishte dhe cungishte mbizotrojnë grumbujt pyjor që kanë cilësi mesatare të materialit drusor dhe një përqindje e vogël deri mesatare.

Pyjet e ekonomisë pyjore Dardhe Qebik nuk janë trajtuar me prerje nga ana e shërbimit pyjor, për arsye të ndryshme. Ato janë përdorur prej dekadash nga ana e komuniteteve për nevojat e tyre. Kryesisht prej tyre janë marrë drutë e zjarrit, lënda e ndërtimit dhe gjethi për blegtorinë.

Aktualisht gjendja e tyre nuk paraqitet e mirë, sepse prerjet nuk janë bërë sipas kriterëve teknike.

Pyjet e mbjellë në mënyrë artificiale si pisha e zeze, geshtenja dhe akacia janë përgjithësisht në gjendje të mirë vegjetative dhe të mbrojtura, shumë rrallë kemi konstatuar dëmtime të tyre për lëndë punimi, vërehen shenja të mira të ripërtritjes së tyre. Pyjet cungishte janë në një gjendje pothuajse të mirë, pavarësisht se nuk janë grumbuj homogjen, vërehet shtimi i dushqeve në të gjithë ekonominë si pjesëmarrës në nënparcelat me pishe te zeze dhe sidomos shtimi i bungs sidomos në pjesën lindore të ekonomisë dhe jo vetëm. Nga këta grumbuj pyjor përvec lëndës së punimit dhe druve të zjarrit, janë prodhuar edhe hunj, thupra, bishta veglash, qymyr druri etj.

Përgjithësisht pyjet dhe shkurret pjesmarrese nuk janë mbrojtur si duhet nga kullotja dhe nga prerjet pa kriter, duke sjellë pjesërisht dhe degradim të tyre. Lënda e punimit në trungishte e cungishte megjithse e pakët, është e cilësisë mesatare, tek haloret është mesatare deri e mire. Masat silvikulturore që parashikohet të zbatohen në grumbujt pyjor, do të rrisin cilësinë e lëndës drusore, duke bërë që të dominojë cilësia mesatare deri e mire.

7.1.5 Biomasa dhe Faktorët e Ekspansionit të Biomases

Sipas përcaktimit të dhënë në Direktivën 2009/28/CE, biomasa është “fraksioni biodegradues i produkteve, mbetjeve dhe mbeturinave me origjinë biologjike nga bujqësia (përfshirë substancat e bimëve dhe kafshëve), pylltaria dhe industrite përkatëse që përfshijnë peshkimin dhe akuakulturën, si dhe fraksioni biodegradues i mbetjeve industriale dhe bashkiake.

Pyjet janë burim shumë i rëndësishëm i prodhimit të biomases. Së pari, biomasa është energji. Lënda drusore zë rreth 35-40% të energjisë për ngrohje në banesa, kryesisht në zonat rurale. Biomasa është lënda e parë, e cila është më e përshtatshme për marrjen e njëkohëshme të energjisë elektrike dhe termike (ngrohje), pra arrihet i ashtuquajtur i bashkëprodhim (kogjeneration). Së dyti, biomasa na rrethon kudo – në mbetjet drusore të shfrytëzimit të ekonomive pyjore, në bujqësi, në akuakulturë, në zonat ligatinore (kallamishtet), në jetën tonë të përditshme, etj. Një nga përparësitë e saj kryesore është se instalimet për energji termike ose elektrike të biomases janë kryesisht lokale, shumë afër konsumatorit. Në këtë këndvështrim, ekosistemet pyjore, shkurretat dhe zonat e mbrojtura mund të nxjerrin fitime nga përdorimi i biomases, nëse mirëmenaxhohen në mënyrë të integruar dhe të qëndrueshme. Sipas përllogaritjeve për ekonominë e marrë në studim, si biomasa në dispozicion për plotësimin e nevojave energjitike mund të merret vëllimi i materialit drusor që del nga masat silvikulturore të planifikuara për dhjetë vitet që zbatohet ky plan mbarështimi. Pra përfitohet një sasi biomase prej **185870** ton biomase në vit si mundësi vjetore vjeljes së lëndës drusore me metoden silvikulturore.

7.1.7 Analiza e rolit të ekonomisë pyjore në sekuestrimin e karbonit

Ashtu si në mbarë vendin edhe në ekonominë e marrë në studim pyjet gjithnjë e më shumë po marrin rëndësi të madhe jo vetëm për lëndën drusore dhe për prodhimet jo drusore por edhe për ndikimin e madh të pazëvendësueshëm në sekuestrimi e karbonit, mbrojtjen e biodiversitetit, zhvillimin e ekonomisë dhe turizmit natyror.

Drurët pyjor, të veçuar apo si pyll, kanë një potencial të madh për të rivendosur ekosistemet e degraduara, për të siguruar ushqim, produkte mjeksore dhe mallra të tjera që kontribuojnë në shëndetin e njeriut. Vetëm pyjet mundësojnë shërbime mjedisore si: mbrojtje nga rrezatimi diellor, mbrojtjen e ajrit nga ndotja, mbrojtje nga erërat dhe zhurma. Vetëm mjedisi pyjor arrin të krijojë një mikroklimë të përshtatëshme për njerezit dhe faunen, për mbrojtjen e burimeve ujore dhe të pjellorisë së tokës, për parandalimin e erozionit të tokës dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike. Pyjet dhe drurët pyjor në mjediset urbane, konsiderohen sot si mjeti më i mirë për të luftuar stresin e qenieve njerëzore, për të përmirësuar gjendjen psikologjike, për shërim më të shpejtë dhe rritje të kapacitetit mendor.

Nëpërmjet realizimit të procesit të fotosintezës, drurët dhe bimët e tjera të pyllit thithin nga ajri gazin karbonik (CO_2) dhe çlirojnë oksigjen (O_2). Gazi karbonik, gazi kryesor i efektit ‘serrë’, pra i mbingrohjes globale, jo vetëm fiksohet prej druëve të pyllit, por njëherësh ky gaz depozitohet për një periudhë të gjatë kohe në dru. Karboni i sekuestruar nga druri vazhdon të qëndroj atje jo vetëm aq sa druri jeton në pyll por edhe për sa kohë në përdorim mobiljet. Është ky arsyetimi bazë që pyllit i atribuohet vetia e sekuestrimit të karbonit.

Llogaritja e biomasës është realizuar duke marrë në konsideratë parametrat e mëposhtëm referuar¹:

1. Dendësia e drurit, bazuar në llojin kryesor (për dushqet është 0.61 dhe për pishën është 0.48)
2. Përmbajtja e karbonit në lëndën e thatë të drurit = 0.5 ose 50% e saj
3. Faktori i ekspansionit të biomasës (BEF) = 1
4. Konvertimi nga C (karbon biomasë) në CO_2 ku raporti është $\text{CO}_2/\text{C} = 44/12 = 3.667$
5. Për cungishtet, raporti ndërmjet biomasës nëntokësore dhe asaj mbitokësore është 0.3 me 0.7 (pra 30% e biomasës gjendet nëntokë dhe 70% e saj mbitoke).
6. Për Trungishtet, raporti $(\mathbf{B}_{mbt})/(\mathbf{B}_{nt})$ është 0.54 (pra 54% është $\mathbf{B}_{mbt}$ dhe 46% është $\mathbf{B}_{nt}$).

Sa më sipër në ekonominë pyjore Dardhe Qebik për 3630.2 ha pyje me rritje mesatare 23719 m^3/vit , llogaritet të sekuestrohet rreth 340793 ton CO_2 afërsisht rreth 93.88 ton/ha

Kjo sasi do të ishte për pyjet e rinj afërsisht dy herë më e lartë nëqoftëse grumbujt pyjor të ekonomisë pyjore Dardhe Qebik do ishin trajtuar me prerje rralluese, prerje që i japin mundësi drurëve për rritje më të madhe dhe të shpejtë.

Ky sekuestrim i kundërvihet mbindotjes së atmosferës me gazin karbonik të çliuar prej gjithë veprimtarive të drejtpërdrejta ose jo të njeriut mbi mjedisin.

Nëpërmjet realizimit të transpiracionit pylli gjithashtu ruan lagështinë dhe freskinë e ajrit. Kurorat e drurëve të pyllit mbajnë mbi vete një masë të konsiderueshme të pluhurit të ajrit, që më pas përcillet në tokë prej ujit të reshjeve. Kurorat e drurëve të pyllit fiksojnë gjithashtu mjaft jone e atome të metaleve të rëndë, që konsiderohen lëndë toksike të rrezikshme për shëndetin e njeriut (përmenden këtu arseniku, kadmiumi, plumbi, etj), si edhe gazra si dioksidi i squfurit, etj.

7.2. Gjendja shëndetsore dhe fitosanitare

Vëzhgimet e kryera në terren tregojnë se kjo ekonomi nuk paraqet probleme shqetësuese për sa i takon gjendjes fitosanitare përjashtuar geshtenja që duhen marre masa urgjente për luftimin e kancerit, grerezes dhe vjezhdules, tek pishat gjate punimeve te terrenit nuk kemi

konstatauar shenja shqetesuese te procesionares se pishes megjithate ky demtues duhet te kihet gjithmone ne konsiderate. Përcaktimi i masave për rehabilitimin e gjendjes (prerja e drurëve me mosha të medha) dhe ndërmarrja e veprimeve konkrete në një periudhë sa më të shkurtër kohore do të ndikojnë në shëndetësimin e gjendjes. Kushtet e jetesës për popullatat lokale janë të vështira prandaj edhe dukuria e prerjeve ilegale është e pranishme. Me krijimin e tregut të punës që do të vijë si rezultat edhe i zbatimit të punimeve silvikulturore, në këtë ekonomi do të pakësohet presioni mbi pyjet, pasi njerëzit duke u punësuar do të krijojnë mundësi për të siguruar të ardhura në rrugë ligjore.

Gjithësesi, njohja e njerëzve me ligjin e pyjeve dhe puna për sqarimin e dobive të pyllit në shërbim të njeriut do të jenë vazhdimisht në fokus të personelit pyjor të zonës.

7.1 Drurët e tharë

Pyjet e ekonomisë Dardhe Qebik kanë gjendje fitosanitare në përgjithësi të mirë. Shumë rralle kemi takuar drurë të dëmtuar ose të tharë, përjashtuar druret e djegur nga zjarret ne parcelat që kemi përmendur më lart dhe pasojat e kancerit të geshtenjes. Ka raste të drurëve të mbytur dhe të nënshtruar sidomos në shkurre në pjesët me dendësi të madhe për efekt të seleksionimit natyral. Propozimi i masave teknike që ndikojnë në përmirësimin e gjendjes shëndetësore të pyjeve është një nga objektivat e planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore. E rëndësishme është të theksohet se ky fenomen nuk ndikon negativisht në biodeversitet dhe gjendjen shëndetësore të grumbujve pyjor në përgjithësi.

7.2.2 Dëmtimet e tjera

Shkaqet e tjera të dëmtimit të grumbujve pyjor janë:

- ✓ rreziku i dëmtimeve masive nga zjarret, prerjet e paligjshme dhe kullotja pa kriter;
- ✓ dëmtimet nga insektet dhe sëmundjet e ndryshme;
- ✓ dëmtime nga erozioni dhe faktorë të tjerë atmosferikë.

Në këtë ekonomi zjarret nuk kanë qenë problem shqetësues sidomos 3 vitet e fundit, pasi zjarret e rena janë krejt rastësore jo të qëllimshme, por kullotja pa kriter dhe prerjet e paligjshme ekzistojnë por në masë shumë të kufizuar. Zjarri i fundit masiv që ra në këto zone preku pjesërisht këtë ekonomi. Në grumbujt pyjor të dushqeve janë vërejtur rënie gjethesh në përmasa joshqetësuese. Gjithashtu dëme në këto pyje në të kaluarën janë shkaktuar nga hiri i dushkut dhe vemja por këtë vit nuk kemi takuar vatra ose ekzemplare me sëmundje dhe dëmtues. Në pyjet e pishës nuk kemi hasur shenja ose qeska të procesionares së pishës, theksojmë se ky dëmtues rrezikon në pishën e zeze. Sëmundje të ndryshme përfshirë kancerin të geshtenjes, grerezes e vjezhdules nuk janë takuar kurse dëmtuesit e tjerë nuk paraqesin rrezik serioz. Dëmtimet nga erozioni të grumbujve pyjor janë të papërfillshme, kurse dëmtimet e teritorit nga ky fenomen megjithatë ka në përmirësim të dukshëm, perseri duhet kujdes dhe nderhyrje për minimizimin deri në eliminim të këtij fenomeni, kjo ekonomi pyjore është një ekonomi me erozion jo shumë shqetësues por në të ardhmen janë parashikuar masa me mbrojtje strikte të pjeseve të erodhuara dhe sisteme për stabilizimin e këtij fenomeni. Vetëm duke patur parasysh këtë fenomen shqetësues grumbujt pyjor të kësaj ekonomie janë përfshirë në statusin funksional prodhues dhe ndërhyrjet nuk do të jenë me prerje rrafsh dhe ricungime por vetëm me prerje me të zgjedhur me celtira dhe me dru të vecantë. Gjithashtu nuk janë evidentuar dëmtime nga orteqet dhe faktorë të tjerë atmosferikë. Në punimet propozuara janë parashikuar edhe masat përkatëse teknike.



Kanceri i geshtenjes

7.3. Prerjet e paligjshme

7.3.1 Prerjet e paligjshme, gjendja aktuale dhe efektet në procesin e planifikimit

Prerjet ilegale sidomos në periudhën e tranzicionit, kanë qënë të pranishme në përmasa të konsiderueshme në këtë ekonomi pyjore, etj. Prerjet ilegale bëhen për lëndë punimi të hollë dhe dru zjarri me qëllim përfitimi si nga individë të shkëputur ashtu edhe nga firma private. Nga kontakte dhe intervista të zhvilluara me popullata vendore rezulton se nga një veprimtari e tillë e paligjshme siguroheshin rreth 20 – 30 % të të ardhurave vjetore.

Prerjet e paligjshme në pyje janë vërtet shumë rrallë në cungishte, në trungishte, këto për lëndë dhe dru zjarri, më të rrezikuara këto pyje janë nga prerjet abuzive për prodhim dru zjarri dhe lende punimi. Më shumë të kërkuar nga tregu kanë qënë dushqet dhe ahu për nevoja të ngrohjes e kullotjes por dhe haloret për lende ndertimi. Në vitet e fundit ky fenomen është paksuar ndjeshëm krahasuar me planin e mëparshëm të menaxhimit ku evidentoheshin prerje ilegale në sipërfaqe të konsiderueshme. Kjo rënie e ndjeshme e prerjeve ilegale ka ardhur për arsye të largimit të popullsisë së zonës, kontrollit më të mirë të territorit dhe ndërgjegjësimit gjithnjë e më të mirë të banorëve të zonës për rëndësinë e pyjeve në cilësinë e jetës në këto zona.

7.3.2 Impakti i prerjeve ilegale në planifikimin dhe mbarështimin e pyjeve

Në këtë zonë pyjet përbëjnë një pasuri natyrore me vlerë dhe interes të veçantë. Për vlerat e larta të biodiversitetit si dhe të faktit që pyjet shërbejnë si një burim i mirë të ardhurash. Prandaj, është e domosdoshme që të bëhet një punë sqaruese me banorët vendas për pasojat që shkaktojnë prerjet ilegale si dhe për vlerën dhe dobinë që sjell një mbarështim i qëndrueshëm i resurseve pyjore.

Një situatë e tillë e detyron personelin pyjor të zonës të marrë masa për një zbatim me rigoroz të ligjit të pyjeve dhe për bashkëpunim më të mirë me organet e pushtetit vendor dhe popullatat lokale. Krahas sa më sipër nga organet e pushtetit vendor si dhe instanca më të larta shtetërore duhet të hartohen strategji për luftimin e varfërisë dhe hapjen e fronteve të reja të punës, në mënyrë që të pakësohet presioni mbi pasurinë pyjore dhe të mos jetë vetëm ajo si burim të ardhurash.

7.4 Rezultatet e Inventarizimit të Kullotave

7.4.1 Tipi dhe cilësia e kullotave

Nga sipërfaqja totale e kullotave, prej 21.3 ha nga të cilat 21.3 janë kullota verore të mirëfillta me bar te mire . Në këto kullota predominon mbulesa barishtore graminace, që zë rreth 40 % të sipërfaqes së tyre, rreth 30% leguminozet dhe 30% të tjera.

7.4.2 Përdoruesit e kullotave dhe koha

Kullotat përdoren nga popullatat që janë në brendësi dhe në afërsi të ekonomisë. Përdorimi i saj në përgjithësi është kolektiv por ka edhe raste të përdorimit familjar.

Kullotat përdoren vetem gjate veres. Edhe kullotja në pyje ka pothuajse këtë grafik por ketu kullotet gjate gjithë vitit. Pyjet e dushkut dhe shkurret pjesmarrese që janë në fakt më të mbingarkuar, kulloten pothuajse gjatë gjithë vitit, veçanërisht ato më afër fshatrave. Gjendja e atyre grumbujve që kulloten sidomos nga dhinë mund të konsiderohet jo e mirë.

7.4.3. Llojet e bagetive

Aktualisht kullotat përdoren për dele dhe më pak për të tjera, kurse kullotat me shkurre dhe pyjet që kulloten dominohet nga kullotja e dhive. Gjedhi përgjithësisht trajtohet me ushqim dhe regjim stallor në periudhën më të madhe të vitit. Blegtoria e imët kullot kryesisht në sezonin vjeshtë –dimër, pjesërisht në verë në keto kullota.

7.4.4 Përdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtës i kullotave

Në këto kullota predominon mbulesa barishtore graminace, që zë rreth 30-50 % të sipërfaqes së tyre dhe diferenca lloje të tjera. Prodhimtaria e biomasës është e ulët dhe mesatarisht arrin në 9-13 kv/ha.

Përgjithësisht përdorimi aktual i kullotave është nën kapacitetin e tyre, shtuar edhe mungesën e masave për përmirësim. Kjo ka sjellë edhe uljen e aftësisë mbajtëse të tyre. Kapaciteti kullosor llogaritet në 1-4 dele/ha, 0.2-1 dhi/ha. 0.5-1 lopë/ha, ndërsa në kullotat me shkurre dhe shkurret që kulloten kapaciteti është 3-6 dhi/ha. Koeficienti i ngrënshmërisë varion, në sezonin më të mirë arrin nga 50 % deri në 80 %, ndërsa mesatarisht arrin në rreth 60 %.

Një përdorim më racional i kullotës, përmirësimi i tyre dhe mos kullotja mbi kapacitet, do të rrisë kapacitetin e tyre në të ardhmen.

7.4.5 Infrastruktura aktuale

Në ekonominë pyjore Dardhe Qebik nga informacioni i grumbulluar për kullotat rezulton se nuk ka lera uji për blektorinë, por për këtë qëllim përdoren projet, burimet ujore të zones.

7.4.6 Problemet mbi kullotjen dhe furnizimin e blegtorisë me bazeëushqimore

Problemi i mprehtë për kullotat është mbikullotja. Territorët kullosorë në përdorim të fshatrave të ekonomisë pyjore Dardhe Qebik përbëhen nga kullotat, që në total zënë një sipërfaqe prej 21.3 ha. Gjatë këtyre viteve nuk janë kryer punime për përmirësimin e tyre. Megjithatë koeficienti i ngrënshmërisë, varion nga 50% deri në 80%.

Përveç kullotave, blegtoria kullotet edhe në pyjet, nga të cilët sigurohet edhe baza ushqimore, për periudhën e dimrit.

8. OBJEKTIVAT E MBARËSHTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

8.1. Objektivat e përgjithshme për planifikimin afat-gjatë

Pyjet janë një pasuri dhe trashëgimni e çmuar kombëtare, Në Nenin 1 të Ligji 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet” citohet: Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e pyjeve si pasuri me rëndësi të veçantë, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës, të tokës, ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhuese, të ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik si detyrime me interes kombëtar dhe ndërkombëtar.” Më tej po Ligji 57/2020, datë 30.04.2020. “Për pyjet” e konsideron planin e mbarështimit si instrumentin kryesor të zhvillimit të qëndrueshëm të fondit pyjor. Bazuar sa më sipër si dhe sipas parimeve të mbarështimit të qëndrueshëm e shumë funksional është realizuar optimizimi i nevojave lokale me mundësitë/kapacitetet ekologjike. Gjatë hartimit të PMPK u krye studimi i territorit, marrja e të dhënave, matjet në pyje si dhe takime me grupe interesi me synim:

- Bashkërendimin me aktorët lokale që veprojnë në zonë edhe me dy - tre ekonomi pyjore fqinje për të ndaluar prerjet abuzive e degradimin e pyjeve.
- Përfshirjen dhe angazhimin e aktorëve lokale, grave e grupeve të disavantazuara në hartimin dhe zbatimin e PMPK.
- Mbrojtjen e përmirësimin e mjedisit të përbashkët.
- Reduktimin e varfërisë në zonat rurale.
- Trajnimin profesional të aktorëve në pyje në të gjitha nivelet (punëtorë, teknikë, udhërrëfyes të guidave të natyrës)
- Përdorimin dhe zhvillimin natyral të pyjeve (automatizimi biologjik)
- Rehabilitimin e përmirësimin e sipërfaqeve pyjore për mbrojtjen e ekosistemeve Natyrore, përmirësimin e peisazheve rural dhe ruajtjen e biodiversitetit.
- Mirëmenaxhimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të pyjeve dhe kullotave.
- Përmirësimin e përdorimit të territorit, të formës së qeverisjes, përmirësim të shkurreve, konvertim të tyre në cungishte dhe cungishteve ekzistuese në trungishte.
- Përdorimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve mbi bazën e vlerësimit me kritere bashkëkohore të gjëndjes biologjike dhe ekologjike të tyre në mënyrë që të përcaktohet realisht potenciali i tyre prodhues pa dëmtuar biodiversitetin dhe pa cënuar çështjet e mbrojtjes së mjedisit.
- Përcaktimin e rolit dhe mënyrës së përfshirjes së palëve të interesuara gjatë hartimit dhe zbatimit të këtij plani.

8.2. Objektivat kombëtare për Zhvillimin e Pyjeve dhe Kullotave

Qëllimi dhe objektivat kryesore kombëtare janë:

- Të sigurohet ruajtja dhe mbrojtja e integritetit të burimeve pyjore dhe kullosore si pasuri natyrore të qëndrueshme e në këtë kuadër edhe biodiversitetit pyjor dhe kullosor;
- Ekonomia pyjore të kontribuojë në zbutjen e varfërisë në zonat rurale.

Gjithashtu prioritetet e qeverisë shqiptare në mbështetje të zhvillimit të sektorit të pyjeve synojnë në:

- Një nxitje të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave drejt konservimit natyror të tyre, mirëmbajtjes së biodiversitetit dhe zhvillimit të eko-turizmit;

- Rehabilitimin e pyjeve të degraduar për t'i rikthyer në kushte optimale të stacionit pyjor përkatës;
- Ripercaktimin i drejtimeve të punës sipas koncepteve afat-gjatë të zhvillimit për administrimin dhe menaxhimin e pyjeve dhe kullotave;
- Formulimin dhe zbatimin e një Programi Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave
- Krijimin e mundësive përfituese në mbrojtjen, konservimin dhe përmirësimin e burimeve pyjore dhe kullosore edhe përmes programeve qeveritare;
- Vazhdimin e bashkëpunimit teknik dhe financiar me agjensitë ndërkombëtare në sektorin e pyjeve dhe kullotave për të siguruar burime të investimeve;
- Ngritjen e kapaciteteve drejtuese dhe menaxhuese në nivelin e njësive të qeverisjes vendore dhe partnereve private si dhe zhvillimi i një programi efektiv të ekstensionit pyjor;
- Nxitjen dhe përfitimin e të ardhurave përmes zhvillimit të mundësive rikrijuese dhe turizmit;
- Përcaktimin e roleve dhe funksioneve të gjithë aktorëve në sektorin e pyjeve dhe kullotave dhe identifikimin e lidhjeve me kritike mes tyre;
- Promovimi i funksioneve sociale dhe mbrojtëse të pyjeve

Mbështetur në objektivat kombëtare të zhvillimit të sektorit të pyjeve dhe kullotave Ligji 57/2020, datë 30.04.2020. “Për pyjet” e konsideron planin e mbarështimit si instrumentin kryesor të zhvillimit të qëndrueshëm të fondit pyjor. Përcaktimi i objektivave në planin e mbarështimit bëhet në përputhje të plotë me interesin e popullatave lokale dhe pa çënuar objektivat rajonale dhe kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm.

8.3. Pajtueshmëria e PMPK me planifikimin rajonal dhe atë në nivel Bashkie

Sipas Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) të Bashkisë Fushe Arrez parashikohet realizimi i ndërhyrjeve të rëndësishme që do të përmirësojnë dhe mbrojnë peizazhin siç janë ripyllëzimi me lloje endemike që mund të zhvillohen në kushtet e territorit të bashkisë; zgjerimi i zonave të mbrojtura dhe hartimi e miratimi i planeve të menaxhimit për to. Gjithashtu një parameter kritik është ruajtja dhe krijimi aty ku mungojnë të zonave ripariante të lumenjve dhe të liqeneve. Këto zona kanë rol shumëfunksional, sepse kontrollojnë flukset (komponentet ushqyes dhe sedimentet) që përmirësojnë cilësinë e ujit, mbrojnë tokën nga erozioni dhe ndotja, kontribuojnë në mbrojtjen nga përmytjet, ndihmojnë në përmirësimin e mikroklimës dhe cilësinë e ajrit dhe funksionojnë si një habitat për faunën dhe në përgjithësi si një bio-korridor.

Peisazhi urban do të përmirësohet ndjeshëm përmes zbatimit të PPV dhe konkretisht nëpërmjet rindërtimit, krijimit të hapsirave të lira publike dhe hapsirave të gjelbra dhe mbjelljes së drurëve dekorativ përgjatë rrugëve. Përveç kësaj edhe në sistemin natyror dhe bujqësor propozohen masa që do të kenë si rezultat shtimin e gjelbërimit:

- Ripyllëzimi në zona të veçanta të degraduara /të shpyllëzuara.
- Rehabilitimi i gurorëve joaktive duke mbjellë llojeve bimësh të përshtatshme, në mënyrë që hapësira të jetë në harmoni me peisazhin e saj rrethues dhe në përputhje me vlerat e tij estetike.

- Realizimi i një rripi të gjelbër perimetrik me drurë të lartë dhe përherëblertë, në mënyrë që të ketë izolim vizual nga rrugët më të afërta.

Pikat e nxehta (hot spots) më të rëndësishme për Bashkinë Fushe Arrez janë të lidhura me përmytjet, zjarret dhe rrëshqitjet e tokës. Masat mbrojtëse për këto fenomene janë të përshkruara qartë në PPV të bashkisë. Por për këto fenomene do të ketë masa të propozuara edhe në planin e menaxhimit të ekonomisë pyjore Dardhe Qebik. Ndër të cilat do të përmendim masat për sensibilizimin e popullsisë lokale lidhur me rëndësinë e pyjeve në cilësinë e jetës së tyre; ndërhyrjet silvikulturore për përmirësimin dhe ripyllëzimin e ngastrave të degraduara dhe dëmtuara nga aktivitetet në kundërshtim me mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu propozimi konkret do të jetë që pyllëzimet dhe ripyllëzimet të projektohen për të krijuar grumbuj pyjore të përzier si më rezistent ndaj fenomeneve të sipërpërmendura. Nga bashkia do të mbështetet një studim për përpilimin e një hartë me mundësi përditësimi për zonat kritike mjedisore për zjarret, rrëshqitjet dhe përmytjet.

8.4. Objektivat kryesore të PMPK

Plani i Mbarështimit të Ekonomisë pyjore Dardhe Qebik ka disa objektiva kryesore, të cilat janë:

- marrja në konsideratë e të gjithë faktorëve që lidhen direkt ose indirekt ndërmjet tyre - popullata lokale, administrimi i pyjeve dhe kullotave, ekoturizmi, interesi që ofron pylli. blektorët etj, pa harruar kufizimin e erozionit, ruajtjen e natyrës dhe stabilitetin e resurseve.
- plotësimi i nevojave të popullatës me material drusor, bazë ushqimore për bagetinë, si dhe përdorimi i prodhimeve jodrusore pyjore vetëm nëpërmjet një zhvillimi të qëndrueshëm të pyjeve.
- harmonizimi i interesave të komunitetit dhe të pjesëmarrësve të tjerë veprues në territorin e kësaj ekonomie në përputhje me mundësinë aktuale dhe potenciale të pyllit.
- grumbullimi i informacionit të shumfishtë, evidentimi i faktorëve sociale dhe ekonomike që ndikojnë në një mbarështrim të qëndrueshëm të pyjeve, Informacionet nuk duhet të përshijnë vetëm ato pjesë që kanë të bëjnë me grumbullin pyjor, por të mundësojë vlerësimin e parametrave ekologjike (klime etj) biologjike (ekosistemet. biotopet, florën -faunën veçanarisht atë të kërcënuar).
- identifikimi i masave që do të merren në të ardhmen dhe harmonizimin e të gjithë faktorëve veprues për përcaktimin e objektivave specifike që janë rezultat logjik i një mbarështrimit bashkëkohor.

8.5. Objektivat specifike të ekonomisë pyjore/NJM

Objektivat specifike të ekonomisë pyjore janë:

- Evidentimi i gjëndjes aktuale në tërë hapësirën e ekonomisë pyjore me anë të matjeve direkte në terren.
- Bashkëpunimi që në fazën e hartimit të PMPK me përdoruesit dhe palët e tjera të interesuara.
- Përdorimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i pyjeve mbi bazën e vlerësimit me kritere bashkëkohore të gjëndjes biologjike dhe ekologjike të tyre.
- Organizimi i takimeve për diskutimin e masave që propozohen, dhe detajimin operacional të planit afat mesëm dhe afatgjatë.

8.5.1 Objektivat specifike mbi përdorimin e tokës, funksionin dhe formën e qeverisjes/mbarështimit

Mbarështimi aktual nga ai i propozuar për sa i takon përdorimit të territorit, formës së qeverisjes dhe funksioneve ka ndryshime të ndjeshme.

Në përdorimin e territorit ka ndryshime pasi janë shtuar **409.95** ha më tepër se mbareshtimi i vitit 1987 si në zërat toka bujqësore, pyje, sipërfaqe me bimësi pyjore, inproduktive etj.

Lidhur me funksionet kryesore dhe të propozuar për grumbujt pyjore të kësaj ekonomie vrehet se:

- Pyjet me funksion prodhues propozohet të jenë **3606** ha ose 100 % të sipërfaqes pyjore.

Si pyje prodhues janë specifikuar pyjet për prodhim lëndë punimi, lende ndertimi dhe dru zjarri.

Të specifikuara këto funksione jepen edhe në tabelën 5.5.1. ku është përcaktuar edhe sipërfaqja për secilin funksion specifik. Ndarja sipas funksioneve të mësipërme ka motive të karakterit tekniko - shkencor dhe social. Në përputhje me objektivat që do të vendos plani i mbarështimit do të fiksohen edhe masat për përmbushjen e tyre dhe çuarjen e pyjeve drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

8.5.2 Objektivat specifike mbi tipet e pyjeve

Objektivi specifik për funksionin prodhues do të jetë shfrytëzimi me prerje para tregtare rrallim i tipit te pare dhe te dyte, pastrime, pjesersht prerje kopshtore e sanitare sidomos i grumbujve të pishës se zeze, geshtenjes, ahut dhe dushqeve si dhe sigurimi i gjeneratës së re të pyjeve, vjelja e një sasive të konsiderueshme materiali drusor pa cenuar vijueshmërinë e prodhimeve drusore gjatë gjithë ciklit të prodhimit. Mbarështimi i qëndrueshëm i pyjeve të rinj gjer në arritjen e moshës së shfrytëzueshmërisë nëpërmjet ndërhyrjes me punime të ndryshme duke siguruar të ardhura nga pylli me sa më pak pasoja negative në mjedis. Nga ndërhyrjet me rrallime paratregtare do të diferencohen drurët me cilësi më të mirë (drurët e së ardhmes) duke siguruar një gjenerate të re me trung të drejtë e cilindrik dhe kurorë pak a shumë simetrike. Objektivi final do të jetë krijimi i pyjeve me cilësi të mesme për prodhim lëndë punimi dhe dru zjarri.

Tipet e grumbullit. si edhe analiza e tyre jepen te Tab.6.1.2.1 - 6.1.2.5 etj. të rezultateve.

Vëllimi drusor në këmbë i pyjeve të Ekonomisë pyjore Dardhe Qebik në total është **263647** m³, vëllimi mesatar i pyjeve trungshte është **100.2** m³/ha, Cungshte **25.19** m³/ha, per trungshtet e parreg. **70.32** m³/ha, cungshtet e perbera kane volum drusor **60.87** m³/ha.

Për çuarjen e grumbujve drejt normalitetit (fondi real drejt fondit normal) janë propozuar masa konkrete në drejtim të harmonizimit të tre komponenteve (Fond-Strukture-Gjëndje) të pyllit, përshtatur funksioneve përkatëse nëpërmjet:

- Rritjes së prodhimtarisë të grumbujve pyjore (ndërhyrja me trajtime e shfrytëzime në grumbujt që kanë arritur moshën).
- Përdorimit optimal të stacionit.
- Sigurimit të gjeneratës së re në rrugë natyrore me prerje të njëpasnjëshme dhe përmiresime.
- Ruajtjes së biodiversitetit, të florës e faunës.

- Mbrojtjes të pyjeve nga zjarret dhe prerjet pa leje.
- Rehabilitimit të infrastrukturës rrugore.
- Krijimit të tregut të punës.
- Përmirësimit të gjëndjes së përkujdesjes për pyjet.

Për hollësi shih pasqyrat “Tipet e vegjetacionit potencial sipas funksioneve, përqindja ndaj totalit të sipërfaqes pyjore” tabela 5.1.1 dhe “Tipet e vegjetacionit aktual sipas funksioneve/përqindja ndaj totalit të sipërfaqes pyjore” tabela 5.5.1

8.5.3 Objektivat specifike silvikulturale

Në përshtatje të mjedisit lokal dhe karakteristikave të grumbullit do të zbatohet sisteme silvikulturale për realizimin e një përdorimi optimal të pyjeve.

Do të kryhen një sërë punimesh silvikulturore duke filluar që nga pastrimet, rrallimet, prerjet e ndryshme silvikulturore si dhe mbrojtje strikte të sipërfaqeve të eroduara dhe sistemime malore. Me anë të tyre synohet përmirësimi i gjëndjes aktuale duke gërshtuar të gjithë komponentët së bashku (teknike dhe sociale).

Ndërhyrjet silvikulturale do të kryhen në përshtatje me objektivat e planit të mbarështimit, kushtet e stacionit dhe cilësinë e grumbullit.

Objektivat kryesore silvikulturore konsistojnë në :

- shfrytëzimin e pyjeve të pjekur e të tej pjekur.
- rrallimin e grumbujve pyjore.
- sigurimin e ripërtëritjes.
- shëndetësimin e grumbujve.
- mbarështimin dhe ruajtjen e biodiversitetit

Të dhënat për sipërfaqen dhe koston e çdo objektiivi jepen në kapitujt përkatës.

8.5.4 Objektivat specifike për kullotat

Në ekonominë pyjore Dardhe Qebik mbikullotja nuk paraqitet si problem pasi kullotat nuk arrijnë të shfrytezohen sipas kapacitetit, por nuk është bërë asnjë punim përmirësues dhe investim për infrastrukturën prandaj kërkohet vëmendje e veçantë për to.

Gjithashtu duhet të përmirësojmë ndjeshëm infrastrukturën në kullota veçanërisht në mbërritshmëri dhe vepra ujëpërëse me qëllim rritjen e kapacitetit mbajtës dhe shmangien e kullotjes së detyruar.

8.5.5 Objektivat specifike mbi biodiversitetin

Shtrirja e ekonomisë pyjore Dardhe Qebik nga 300 m mbi nivelin e detit deri 1685 m mbi nivelin e detit, ekspozicioni i saj me luginat dhe shpatet, burime ujore, përrenjtë, përroskat e shumta e bëjnë këtë ekonomi mjaft të larmishme nga pikpamja e biodiversitetit.

Detyra jonë është që këtë biodiversitet ta mbrojmë dhe ta shtojmë me synim për ta bërë me atraktive zonën, me drejtim zhvillim agroturizmi dhe turizmit natyror.

Rreziqet për biodiversitetin kanë qënë dhe mbeten shfrytëzimet intensive, prerjet illegale, mbikullotja në afërsi të fshatrave dhe zjarret.

Për përmirësimin e biodiversitetit, që synojmë veçanërisht të llojet dhe varietetet gjenetike.

8.5.6 Objektivat specifike mbi gjëndjen shëndetsore

Vëzhgimet e kryera në terren tregojnë se kjo ekonomi nuk paraqet probleme shqetësuese për sa i takon gjëndjes fitosanitare (ka pak drurë të vjetër me majë të tharë).

Përcaktimi i masave për rehabilitimin e gjëndjes (prerja e drurëve me mosha të mëdha, heqja e drurëve të thyer, te djegur e të rrëzuar, luftimi i kancerit të geshtenjes dhe krasitja e degeve të poshteme të pishave) dhe ndërmarrja e veprimeve konkrete në një priudhë sa më të shkurtër kohore do të ndikojnë në shëndetësimin e gjëndjes. Kushtet e jetesës për popullatat lokale janë të vështira prandaj edhe dukuria e prerjeve ilegale është e pranishme dhe e ndjeshme sa i takon përmasave. Prejet ilegale janë dhe mbeten problem shqetësues për pyjet dhe strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki.

Për të frenuar këtë fenomen rekomandohet marrje e përgjegjësisë jo vetëm nga personat përgjegjës direkt për mbrojtjen e pyjeve por edhe nga institucione të tjera të pushtetit qendror dhe lokal. Kjo gjë do të ndihmonte shumë në zbatimin e ligjit për ndalimin e prerjeve me qëllime fitimi, të cilat në pyje shkaktojnë pasoja të pariparueshme. Pra kështu, del me evident zbatim i rigoroz i ligjit, transferimi i përgjegjësisë dhe kompetencave drejt bazës e deri tek përdoruesi i përditshëm. Një gjë e tillë është e parashikuar edhe në strategjinë e zhvillimit të sektorit të pyjeve.

8.5.7 Objektivat specifike mbi faunën

Për mbarështrimin e gjahut objektiv kryesor për periudhën e vlefshmërisë të planit do të jetë krijimi i kushteve të përshtatshme për ushqim, riprodhim dhe folezim.

Pasuria faunistike mund të shndërrohet në një bazë për zhvillimin e gjuetisë turistike në ekonomi gjë që është në interes të gjithë komunitetit të zonës.

Nga informacionet e grumbulluara nëpërmjet intervistave të ndryshëm dhe disa vëzhgimeve konstatohet se në territorin e pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore gjenden lloje të ndryshëm kafshësh dhe shpendësh të egër. Ndër llojet më të rëndësishëm por që hasen rrallë janë: ariu, ujku, derri i eger, kaprolli, thëllëza e malit, pëllumbi i egër dhe qukapiku. Llojet që takohen zakonisht janë dhelpa, lepuri, laraska, grifsha, sorra, harabelat dhe mëllenja. Gjithashtu gjenden Iriqi dhe breshka. Prania e tyre tregon për një biodiversitet të kënaqshëm. Zhvillimi i popullatave të faunës së egër ka ndikim pozitiv mbi ekosistemet pyjore dhe mbi mbarështrimin e pyjeve. Aktualisht situata me pyjet ka filluar të përmirësohet e për pasojë edhe fauna e egër nuk është shumë e kërcënuar. Megjithatë është e nevojshme të merren masa për një kontroll më të mirë të gjuetisë.

Kryerja e një inventari të gjahut mbi kritere tekniko-shkencore do të ndihmonte së tepërmi në monitorimin e popullatave dhe përcaktimin e gjëndjes së tyre. Me një informacion të tillë mund të merren masa të plota për mbarështrimin shkencor të gjahut. Ndalimi i gjuetisë pa leje dhe me mjete të ndaluara gjuetie është një objektiv që kërkon seriozitet dhe këmbëngulje gjer në realizimin e tij të plotë.

8.5.8 Objektivat specifike për pyjet me funksion prodhues

Objektivi specifik për funksionin prodhues do të jetë shfrytëzimi rracional si dhe sigurimi i gjeneratës së re të pyjeve, vjelja e një sasive të konsiderueshme materiali drusor pa cenuar vijueshmërinë e prodhimeve drusore gjatë gjithë ciklit të prodhimit. Mbarështimi i pyjeve të

rinj gjer në arrijtjen e moshës së shfrytëzueshmërisë nëpërmjet ndërhyrjes me punime silvikulturore duke siguruar të ardhura nga pylli me sa më pak pasoja negative në mjedis. Nga ndërhyrjet me rrallime do të diferencohen drurët me cilësi më të mirë (drurët e së ardhmes). Objektivi final do të jetë grumbuj pyjore të përmirësuar nga të cilët do të sigurohet lëndë punimi dhe dru zjarri në vazhdimësi.

Për sigurimin e druve të zjarrit duhet të shfrytëzohen parcelat e përcaktuara për trajtime me prerje kopshtore e sanitare dhe materiali drusor që do të rezultojë nga prerjet e ndryshme silvikulturore. Do të përcaktohen detyrimisht parcela të veçanta për prodhimin e druve të zjarrit për banorët e zones, përveç druve të zjarrit të rezultuara nga ndërhyrjet silvikulturore apo drurët e dëmtuar nga faktorët atmosferike.

Potencialisht kjo ekonomi ka bimë mjekësore, eterovajore e tanifere që janë një potencial për sigurimin e të ardhurave të banorëve.

Për këtë do të respektohen të gjitha kriteret teknike mbi mënyrën e grumbullimit të tyre me qëllim të sigurohet vazhdimësi prodhimi. Mund të përmëndim frutat e geshtenjes, luleshtrydhja, boronica, dëllinja e kuqe, trëndafili i egër, murrizi, bime të ndryshme barishtore me vlera medicinale, myshqet, likenet, kerpudhat, vjezhdulla etj.

8.5.9 Objektivat specifike për pyjet me funksion mbrojtës

Për 10 vjeçarin e vlefshmërisë së planit, objektivat specifike për funksionin mbrojtës dhe pse nuk kemi grumbuj me funksion të tillë, do të konsistojnë në fuqizimin e funksionit mbrojtës të pyjeve duke mos lejuar prerje e kullotje si dhe duke organizuar një punë të pa ndërprerë propagandistike për ndërgjegjësimin e popullatës lokale për efektet mbrojtëse të pyllit ndaj tokës, klimës, ujrave dhe infrastrukturës. Kjo do të bëjë që mbrojtjen e pyjeve me këtë funksion, ku si të tilla do të konsiderohen pyjet e rralla të pishes që janë me kuroredendesi nën 0.6, ta marrin në dorë vetë banorët vendas, gjë që do të garantojë zbatimin e këtij objektivi. Aktualisht në këtë ekonomi nuk kemi propozuar pyje me funksion mbrojtës, por në të ardhmen në sajë të trajtimit dhe ecurisë së zhvillimit të biodiversitetit të kësaj ekonomie mund të parashikohen dhe pyje me funksion mbrojtës.

8.5.10 Objektivat specifike për pyjet me funksion rekreacioni

Për realizimin e objektivave të vendosura për pyjet me funksion rekreacioni duhet në fillim të krijojmë mundësinë e zhvillimit të aktiviteteve turistike rekreative dhe çlodhëse për njerëzit. Kjo gjë arrihet duke bërë prezent të mirat dhe produktet që ofrojnë pyjet e ekonomisë Dardhe Qebik tek operatorët turistik që kërkojnë të zhvillojnë të tilla aktivitete. Në këtë ekonomi ka indicje për një funksion të tillë por mbetet e hapur mundësia që grumbuj pyjor të vecantë në të ardhmen mund të trajtohen si të tilla.

8.5.11 Objektivat specifike për pyjet me funksion konservues

Duhet të theksojmë se funksioni konservues i pyjeve është një objektivi që kërkon në radhë të parë grumbuj pyjor që të plotësojnë kriteret teknike dhe stacionale për një funksion të tillë, duhet një personel pyjor me kualifikim të lartë profesional pasi dhe puna që kryejnë është punë me të tillë nivel.

Kërkohet korrektësi në zbatimin e ligjit për përdorimin e territorit. Po ashtu edhe për këtë funksion specifik nuk ka grumbuj pyjor të propozuar. Ndoshta në mbarështrimin pasardhës do të mundësohen funksione specifike pasi do të kemi gjëndje dhe kushte më të favorshme

për një gjë të tillë ku si të tillë në të ardhmen mund të trajtohen grumbuj të vecante të pishës se zeze, ahut me bredh, të dushqeve, ndoshta dhe të disa llojeve të tjera.

Ne grumbujt pyjor të kësaj ekonomie nuk kemi akoma grumbuj pyjor që të trajtohen me funksion konservues por ne një të ardhme të afert si të tilla mund të parashikohen një pjesë e grumbujve me pishë të zeze, geshtenje, ah dhe dushqe.

9. MASAT E PLANIFIKUARA NË KUADËR TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

9.1. Prerja vjetore e lejuar/mundësia vjetore e shfrytëzimit

Nga analiza e grumbujve pyjor të ekonomisë rezultojnë se ata janë në kryesisht në fazën e zhvillimit të rinisë, parapjekurisë dhe pjekurisë. Vërtet grumbujt pyjor janë në këto faza zhvillimi por dimensionet e tyre dendrometrike janë të konsiderueshme po ashtu për një periudhë të gjatë kohore nuk janë kryer punime silvikulturore.

Të gjitha produktet pyjore që do të vilen në periudhën 10-vjeçare janë ato që do të rezultojnë prej trajtimit silvikulturore të pyjeve (Rrallime paratregtare, prerje sanitare e kopshtore në trugishte e cungishte).

Materiali që rezultojnë nga këto ndërhyrje përcakton mundësinë vjetore të shfrytëzimit. Nga llogaritjet e kryera rezultojnë se për një periudhë 10 vjeçare do të nxirret nga pylli **18970 m³** material drusor, kryesisht dru zjarri në cungishte, por dhe lëndë punimi e lende e holle për ndertimet e tjera nga prerjet komerciale, fitosanitare dhe kopshtore në dru të vecantë në pisha, ah, bredh, dushqe e geshtenje.

1. Mundësia vjetore e shfrytëzimit sipas metodës së rritjes vijuese (treguese) është 23712 m³ x 0.8 = 18970 m³ në vit. Është parashikuar që mundësia vjetore e shfrytëzimit të jete sa 80% e rritjes vijuese.

Mundësia e shfrytëzimit sipas rritjes vijuese (treguese) është 18970 m³/vit

2. Mëqenese grumbujt pyjor të ekonomisë pyjore Dardhe Qebik janë grumbuj të rinj, ku trugishtet janë në klasën e dytë të moshës dhe cungishtet në klasën e dytë dhe të tretë të moshës; me konkretisht të gjithë grumbujt janë në moshë 20-35 vjeçare, mendojmë që si mundësi shfrytëzimi mund të përdoret mundësia silvikulturore e shfrytëzimit.

Konkretisht sasia e materialit drusor që duhet të hiqet sipas nevojës me ndërhyrje silvikulturore është 52651 m³, kjo e sasi e ndarë për 10 vjet është e barabartë me 52651 : 10 = 5265 m³ material drusor në vit.

9.2. Prerja vjetore silvikulturore

Në ndërhyrjet silvikulturore janë parashikuar të kryhen, rrallime të tipit të parë dhe të dytë, prerje fitosanitare, pastrime, krasitje degesh në pisha të zeza në 233 ha, në cungishte e cungishte .

Gjatë këtij 10 vjeçari janë parashikuar ndërhyrje gati në çdo parcelë pyjore, kjo për faktin që të vihet dorë në këta grumbuj me qëllim rritjen e prodhimtarisë së tyre në të ardhmen (në përfundim të këtij plani).

Në këtë ekonomi pyjore në trungishte dhe cungishte do të ndërhyhet me parimin e qëndrueshmërisë së pyjeve, prandaj masat do të jenë rrallime te tipit te pare dhe te dyte, prerje fitosanitare. Rrallimet e tipit te pare do te kryhen ne 463 ha duke hequr 9358 m³ material drusor, rrallimet e tipit te dyte ne 1464 ha duke hequr 41619 m³ material drusor, prerjet kopshtore ne 29 ha duke hequr 1674 m³ material drusor, me pastrime do te trajtohen 578 ha. Ne total sipas nevojën për ndërhyrje silvikulturale do te hiqen 52651 m³ material drusor nga ku rezultojne rreth 30 % ose 15795 m³ lende e holle dhe lende ndertimi dhe 36856 m³ dru zjarri por dhe lende e holle, bandiera e asortimente te tjera te imta per nevojat e ekonomise dhe te komunitetit.

Në grumbujt cungishte që kanë shkurre poshtë është parashikuar heqja në një masë të arsyeshme e shkurreve me qëllim favorizimin e dushqeve, frashërit etj. Qëllimi është që në të ardhmen një pjesë e shkurreve të kthehen me cungishte, duke favorizuar dushqet me të gjitha mënyrat.

Grafiku i realizimit të ndërhyrjeve jepet nga *tab 9.3.1.1.* po aty jepen numri i ngastrës, sipërfaqja, intensiteti i ndërhyrjes, shkalla e urgjencës dhe vëllimi i materialit drusor që do të rezultojë të hiqet.

9.3. Planifikimi vjetor i masave

9.3.1 Masat ne Pyje

Prerjet silvikulturale për ekonominë pyjore Dardhe Qebik përfshijne sasinë e volumit të materialit drusor që do të rezultojë nga masat e marra si trajtime silvikulturore për çdo vit brenda planifikimit dhjetë vjeçar. Në këtë ekonomi pyjore është parashikuar të ndërhyhet me prerje shfrytëzuese në pak grumbuj pyjor që kanë arritur pjekurinë dhe kushtet për ndërhyrje. Masat silvikulturore janë si më poshtë vijon:

Planifikimi vjetor i ndërhyrjeve – Pyje

Tab.9.3.1.1

Planifikimi vjetor I ndërhyrjeve						
Viti	Ngastra	Sip. Ha	Metoda e trajtimit	Siperfaqja qe do te ndërhyhet ha	Volumi i materialit qe sigurohet m ³	Shenim % e ndërhyrjes
2026	133a	24.08	Rrallim tipi 1	21.7	311.8	25% nr dr
2026	135a	41.2	rrallim tipi 2	37.1	1205.8	30% nr dr
2031	53a	17.53	rrallim tipi 2	14	308.8	30% nr dr
2027	58a	21.11	rrallim tipi 2	19	581.5	30% nr dr
2027	92c	10.01	rrallim tipi 1	9	131.5	25% nr dr
2027	23b	14.55	rrallim tipi 1	13.1	228.5	25% nr dr
2027	66a	13.62	rrallim tipi 1	12.3	480.8	30% nr dr
2027	71a	12.85	rrallim tipi 1	11.6	314.3	25% nr dr
2027	76b	3.14	rrallim tipi 1	2.5	46.9	20% nr dr
2027	78a	12.17	rrallim tipi 1	11	371.1	25% nr dr
2027	79a	38.14	rrallim tipi 1	34.3	966.1	30% nr dr
2031	82a	31.81	rrallim tipi 1	28.6	775.8	25% nr dr
2027	84a	12	rrallim tipi 1	9.6	209.3	25% nr dr

2028	87a	60.25	rrallim tipi 1	54.2	2335.7	25% nr dr
2027	36a	15.8	rrallim tipi 2	14.2	412.3	30% nr dr
2027	37a	13.95	rrallim tipi 2	12.6	333.5	30% nr dr
2031	44a	11.14	rrallim tipi 2	10	398.7	30% nr dr
2027	56a	27.98	rrallim tipi 2	22.4	539.8	30% nr dr
2027	57a	1.24	rrallim tipi 2	1.1	22.1	30% nr dr
2031	62a	46.13	rrallim tipi 2	41.5	1324.3	30% nr dr
2028	63a	43.1	rrallim tipi 2	38.8	1614.1	30% nr dr
2031	64a	31.2	rrallim tipi 2	28.1	752.5	30% nr dr
2028	65a	17.36	rrallim tipi 2	15.6	529.9	30% nr dr
2029	67a	22.08	rrallim tipi 2	19.9	830.7	30% nr dr
2029	68a	33.89	rrallim tipi 2	30.5	988.7	30% nr dr
2031	69a	61.22	rrallim tipi 2	55.1	1618.2	30% nr dr
2032	74a	35.32	rrallim tipi 2	31.8	1049	30% nr dr
2027	77a	14.51	rrallim tipi 2	13.1	635.4	30% nr dr
2028	83a	18.72	rrallim tipi 2	16.8	536	30% nr dr
2029	85a	11.84	rrallim tipi 2	10.7	418.6	30% nr dr
2032	86a	47.62	rrallim tipi 2	42.9	2600.4	30% nr dr
2029	89a	38.31	rrallim tipi 2	34.5	1453.8	30% nr dr
2032	90a	34.89	rrallim tipi 2	31.4	1772.4	30% nr dr
2033	92a	17.87	rrallim tipi 2	16.1	793.5	30% nr dr
2033	60a	16.9	rrallim tipi 1	15.2	374.9	25% nr dr
2028	27a	15.27	rrallim tipi 2	13.7	289.7	30% nr dr
2029	35a	15.89	rrallim tipi 2	14.3	550.2	30% nr dr
2033	38a	11.82	rrallim tipi 2	10.6	226.1	30% nr dr
2029	39a	12.95	rrallim tipi 2	11.7	541.2	30% nr dr
2030	45a	27.99	rrallim tipi 2	25.2	633.5	30% nr dr
2030	46a	17.72	rrallim tipi 2	15.9	543.6	30% nr dr
2033	61a	21.21	rrallim tipi 2	19.1	388.3	30% nr dr
2030	88a	47.45	rrallim tipi 2	42.7	2066.6	30% nr dr
2030	93a	26.24	rrallim tipi 2	23.6	934.4	30% nr dr
2030	94a	37.06	rrallim tipi 2	33.4	616.8	30% nr dr
2033	42a	13.14	Kop.dr.vec	10.5	660	30% nr dr
2033	16a	22.36	rrallim tipi 2	20.1	373.7	30% nr dr
2033	17a	31.36	rrallim tipi 2	28.2	527.1	30% nr dr
2033	83b	0.6	rrallim tipi 2	0.5	8.1	30% nr dr
2033	21a	19.6	rrallim tipi 2	17.2	414.5	30% nr dr
2029	22a	25.96	rrallim tipi 2	20.8	474.8	30% nr dr
2030	54a	25.23	rrallim tipi 2	22.7	478.7	30% nr dr
2033	59a	18.51	rrallim tipi 2	16.7	442	30% nr dr
2033	57b	3.99	rrallim tipi 1	3.6	49	25% nr dr
2033	40a	8.1	rrallim tipi 2	7.3	157.2	30% nr dr
2033	50a	26.29	rrallim tipi 2	23.7	621.6	30% nr dr
2033	92b	7.44	rrallim tipi 2	6.7	257.6	30% nr dr
2034	96b	24.08	rrallim tipi 2	21.7	530.9	30% nr dr

2034	47a	23.47	Kop.dr.vec	18.8	1014	30% nr dr
2034	20a	24.36	rrallim tipi 2	21.9	365.6	30% nr dr
2031	114a	15.48	rrallim tipi 1	13.9	86.8	25% nr dr
2034	115e	10.08	rrallim tipi 1	8.1	57.4	25% nr dr
2034	125a	2.12	rrallim tipi 1	1.7	23.4	30% nr dr
2026	140a	12.24	rrallim tipi 1	11	138.1	25% nr dr
2026	142a	8.12	rrallim tipi 1	7.3	76.6	25% nr dr
2034	51a	13.77	rrallim tipi 1	12.4	197.2	25% nr dr
2034	98a	18.53	rrallim tipi 1	16.7	271.9	25% nr dr
2026	100a	38.58	rrallim tipi 2	34.7	896.3	30% nr dr
